



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Gjuhë Gjermane dhe Angleze”
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.As.Dr.Valbona Loshi (Softa)

2. Dr. Brunilda Vercani

Mars/ 2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Gjuhë Gjermane dhe Angleze
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 565, datë 27.06.2013 (për miratimin e kuotave, me emërtimin Bsc. Gjermanisht Anglisht).
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendimit të Senatit Nr. 57, datë 14.06.2018, miratuar me shkresë nga MASR Nr. 7238/I Prot., datë 31.08.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr. 288, datë 22.10.2020.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 14 PAE /8 PAK 2021-2022 13PAE/ 5 PAK 2020-2021 13 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 35 studentë 2021-2022 35 studentë 2022-2023 24 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" është program i ciklit të parë të studimeve, i cili ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, (UAMD). Institucioni i arsimit të lartë publik, Universiteti "Aleksandër Moisiu" u themelua me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005 dhe si fillim përbëhej nga tre njësi kryesore, ndër to edhe Fakulteti i Edukimit. "UAMD" u riorganizua në vitin 2010 me VKM Nr. 685, në pesë njësi kryesore: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike dhe Fakulteti i Studimeve Profesionale. Programi i studimit, për herë të parë, u hap me Vendim të Senatit Akademik Nr. 8/2013 si program i ciklit të parë me emërtimin "Gjermanisht-Anglisht" dhe në vitin 2018 u riorganizua me Vendim Senati Nr.57, me ndryshime deri në masën 20%, i përshtatur me emërtimin Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze". Ky riorganizim erdhi për shkak të ndryshimeve të legjislacionit në fuqi për Arsimin e Lartë dhe u miratua nga MASR më 31.08.2018.

Organizimi, ndarja dhe strukturimi i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" mbështetet plotësisht në legjislacionin në fuqi dhe përbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr.80/2015 dhe specifikat e përcaktuara në VKM nr.40/2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL", sipas të cilit lëndët në planin mësimor të programit të studimit ndahen në kategoritë (A-E) dhe vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Në këtë program studimi, lëndët bazë zënë (20 %) të peshës së krediteve në kuadrin e veprimtarive formuese, lëndët karakterizuese zënë (52 %), lëndët ndërdisiplinore/integruese zënë (13 %), lëndët plotësuese zënë (11%), si edhe detyrime përmbyllëse zënë (3%). Në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 kohëzgjatja normale e programit të studimit është tre (3) vite akademike, të ndara në 6 semestra, me nga 15 javë mësimore secila. Kreditet e përfunduara në përfundim të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" janë 180 (ECTS), të shpërndarë në mënyrë të barabartë, përkatësisht 60 kredite për vit.


Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" për vitin akademik 2022-2023, është në total njëzet e dy (22), nga të cilët (14) personel akademik efektiv, (PAE) dhe (8) personel akademik me kontratë (PAK). PAE i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga (2) Profesorë të Asociuar; (8) Doktorë të Shkencave; (3) MSc dhe një (1) Docent. Përsa i përket kualifikimeve të personelit akademik me kontratë, GVJ konstaton se për vitin akademik 2022-2023 është angazhuar një (1) personel akademik (PAK) "Doktor i Shkencave" dhe (7) (PAK) "Master i Shkencave".

Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka kaluar dy herë procesin e akreditimit periodik institucional, në vitin 2017 dhe në vitin 2022; nga procesi i fundit, institucioni është akredituar pozitivisht për katër (4) vite. Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit dhe i përket nivelit (6) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" (PSZHPS) ka përcaktuar që ky program studimi synon të përgatisë specialistë në fushën e metodikës së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj dhe specialistë të mësimdhënies së gjuhës



gjermane në të gjithë nivelet e arsimit parauniversitar të studentëve për gjuhën gjermane. Gjithashtu, PSZHPS parashikon se ky program studimi është ideuar për të siguruar diploma me një kualifikim profesional në mësimdhënien e gjuhës angleze dhe mundëson zhvillimin profesional për Mësuesit e Gjuhës Angleze, të interesuar në përdorimin e gjuhës gjermane, në punë, apo kontekste akademike. GVJ shprehet në brendi të RVJ-së mbi gjetjet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof.as.dr. Valbona Softa dhe Dr. Brunilda Vërçani , me mbështetjen e koordinatores të ASCAL, Msc. Anilda Beqiraj, ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë gjermane dhe angleze” kaloi në disa hapa. Fillimisht grupit të vlerësimit të jashtëm iu vu në dispozicion dosja e plotë e vetëvlerësimit me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për këtë process.

Pas studimit dhe shqyrtimit të dosjes grupi i vlerësimit të jashtëm hartoi kuadrin e qartësimeve dhe saktësimeve të informacionit të paraqitur në dosje. Për plotësimin dhe konkretizimin e këtyre informacioneve grupit të vlerësimit iu vunë në dispozicion dy ditë për të zhvilluar një vizitë në institucion, e cila kishte një agjendë të përcaktuar qartë.

Vizita në institucion u zhvillua në datat 5 dhe 6 tetor 2023. Gjatë kësaj vizite u zhvilluan takime me dekanen e Fakultetit të Edukimit, përgjegjësen e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, me studentët, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe standardeve të Cilësisë, me përfaqësues të Sektorit të burimeve Njerëzore, të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe me sekretarinë mësimore. Në fund të vizitës u realizua një vëzhgim i mjediseve mësimore, laboratorit, bibliotekës etj.

Gjatë këtyre takimeve grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh më tej me organizimin dhe drejtimin e programit të studimit, me burimet financiare, me punën dhe përpjekjet e stafit për kualifikim të mëtejshëm, me përpjekjet për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me mbështetjen që i ofrohej studentëve dhe me respektimin e të drejtave të tyre, me infrastrukturën dhe logjistikën në funksion të programit të studimit.

Në vijim grupi i vlerësimit hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm.



AKRONIME

DGJH	-Departamenti i Gjuhëve të Huaja
DVV	-Dosje e Vetëvlerësimit
FE	-Fakulteti i Edukimit
GVJ	-Grupi i vlerësimit të jashtëm
GVB	-Grupi i vlerësimit të brendshëm
KPGSCIPS	-Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit
NJSBC	-Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PA	-Personel Akademik
PS	-Programi i studimit
PSZHPS	-Plani Strategjik i Zhvillimit të programit të studimit
RRFOSBSC	-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
RVJ	-Raporti i vlerësimit të jashtëm



Lënda: Shqyrtim nga GVJ i komenteve të Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, (UAMD), për vlerësimin programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”

Referuar vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, (UAMD), GVJ u informua se institucioni është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.02.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. Prot. 19/22. “UAMD” përcolli në ASCAL “Komente në lidhje me draft raportin” me anë të shkresës me Nr. Prot. 403/1, më datë 29.02.2024, me të cilat ekspertët e vlerësimit u njohën dhe shprehin argumentat si më poshtë:

1. Për Komentin që i përket standardit Standartit III.4/ Kriteri 1:

GVJ shqyrtoi sqarimin e institucionit lidhur me këtë kriter përse i përket mosdërgimit në ASCAL të Planit Strategjik të zhvillimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” në variantin përfundimtar, por variantin ‘Draft’ të tij, konstatim për të cilin GVJ shprehet se institucioni ka patur kohën e duhur në dispozicion për të dërguar variantin përfundimtar pas vizitës në institucion në seksionin e dokumentacionit shtesë. Pasi GVJ vendosi ta konsiderojë këtë variant përfundimtar, vëren se ky Plan Strategjik është më së tepërmi një sintezë e analizës së punës së Departamentit të Gjuhëve të Huaja, të programit të studimit dhe të Studimit të Tregut të Punës. GVJ vëren se në kategorinë “Mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional” të këtij plani përcaktohet se studentët e diplomuar në këtë program studimi *“mund të punojnë si mësues në qendrat e gjuhëve të huaja” duke mos veçuar se cili profil gjuhe e ka këtë mundësi sikurse është përcaktuar në pikën e tretë të komentit të institucionit “mësues për gjuhën gjermane”. Po ashtu, ky parashikim në Planin Strategjik anashkalon udhëzimet ligjore në fuqi që përcaktojnë se në përfundim të programit Bachelor, të diplomuarit nuk mund të punësohen si mësues. Komenti nga institucioni për këtë kriter shpreh që programi i studimit përmban 25 % të lëndëve në gjuhën angleze. GVJ vlerëson se studentët e këtij programi studimi nuk mund të punësohen mësues në qendrat e gjuhëve të huaja me 25 % të njohurive që përmban programi i studimit për gjuhën angleze. GVJ i mbetet faktit se plani mësimor i këtij programi studimi reflekton se lëndët për gjuhën gjermane në kategorinë e lëndëve karakterizuese (B) kanë më tepër peshë në kuadrin e përgjithshëm të veprimtarive formuese të tij, në një numër shumë të lartë krahasuar me lëndët e gjuhës angleze, (raporti 12/2). Po ashtu, GVJ gjykon se dhënia e përparësisë së gjuhës gjermane në masën 70%, krahasuar me gjuhën angleze (25%) në kuadrin e përgjithshëm të veprimtarive formuese nuk sistemohet vetëm me përmirësimin/ndryshimin e Planin Strategjik të programit të studimit, i cili përpilohet para se të ofrohet programi i studimit.*

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

2. Për Komentin që i përket standardit VI.3/ Kriteri 1:

GVJ vlerëson sqarimin e institucionit, në lidhje me plotësimin e Formularit të Vlerësimit të studentëve në ‘Google Forms’ për vitin akademik 2020-2021 për shkak të mosprezencës së



studentëve në auditore në kushtet e zhvillimit të mësimi 'On-line', edhe pse kjo evidencë nuk përmendet në RVB, si dhe në takimin në institucion, GVJ e mori atë në shqyrtim dhe shprehet se vlerësimi i realizuar nga studentët i referohet ngushtësisht cilësisë së mësimdhënies on-line për procesin mësimor në kushte të jashtëzakonshme. Ndërkohë, GVJ në vlerësimin e tij, shprehet për plotësimin nga studentët të instrumentave të posaçëm të cilësisë, të hartuar dhe miratuar specifikisht për vlerësimin e personelit akademik, të cilët aplikohen periodikisht (*Ref. 68 Formulari i vlerësimit të stafit akademik nga studentët-AADF- Cleanscore*).

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

3. Për Komentin që i përket standardit VI.3/Kriteri 4:

GVJ mer në konsideratë të gjithë dokumentacionin e paraqitur përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm sipas procedurës dhe rregullores për këtë proces dhe për pasojë nuk ka kompetenca për të vlerësuar të dhënat, të cilat do të përditësohen dhe publikohen në vazhdim nga institucioni, sikurse është shprehur në komentin për këtë kriter.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Gjuhë Gjermane dhe Angleze”

I. OFRIMI PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Referuar Raportit të Brendshëm të Vlerësimit (RVB), si edhe duke u mbështetur në dokumentacionin shoqërues në Dosjen e Vetëvlerësimit, (DVV), Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë Publik, Universiteti “Aleksandër Moisiu” referuar në këtë Raport Vlerësimi me shkurtimin “UAMD”, është themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005 dhe është riorganizuar me VKM Nr. 685, datë 25.08.2010 në pesë njësi kryesore, një ndër të cilat është Fakulteti i Edukimit, i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” (Evidenca nr.4 - Procedura ASCAL - Vendim Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës; Evidencë-124- VKM Nr. 685, datë 25.8.2010 për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe Fakultetit të Edukimit).</p> <p>Fillimisht, programi i studimit u hap me Vendim Nr.8/2013 të Senatit Akademik të “UAMD” dhe VKM Nr.565, datë 27.06.2013 me emërtimin “Gjermanisht, Anglisht” (Evidenca nr.33 -Vendim Senati për Hapjen e Programit; Evidencë 2- Aplikimi, kontrolli i të dhënave institucionale dhe të programit të studimit). Më pas u riorganizua me Vendim Senati Nr.57/2018 sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në vend, me ndryshime deri në masën 20%, i përshtatur me emërtimin Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" dhe u miratua nga MASR më 31.08.2018 (Evidencë nr. 3 Vendim Senati Per riorganizimin e programit Bachelor ne "Gjermanisht Anglisht" (UAMD); Evidencë nr.1- Procedura ASCAL - Shkresë Per miratimin e riorganizimit te programeve te Fakultetit te Edukimit, UAMD).</p> <p>GVJ konstaton se institucioni i arsimit të lartë publik “UAMD”, i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, të parashikuara në Statutin e universitetit “Aleksandër Moisiu”, (Neni 3, 4, 7 - Misoni, Qëllimet dhe Zhvillimi i Veprimtarisë së institucionit),</p>



	<p>si edhe në planin strategjik të tij (Evidenca nr.2- Statuti UAMD; Evidenca-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025). Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka kryer dy procese të akreditimit periodik institucional, në vitin 2017 dhe në vitin 2022. Nga procesi i fundit është akredituar pozitivisht për katër (4) vite, (Evidenca-110-Vendimi i Bordit të Akreditimit për UAMD, 2017; Vendim Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, e cila reflektohet në Statutin e UAMD-së dhe Rregulloren e Fakultetit të Edukimit si njësi kryesore, e cila ofron këtë program studimi (Evidenca nr.2 - Statuti UAMD; Evidenca-7-Rregullore FE 2019). GVJ konstaton se programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në rregulloren e të cilit shprehet qartë misioni i këtij departamenti për të ofruar programe bashkëkohore studimi, të cilat synojnë të formojnë specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, përkthim dhe interpretim, si edhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushat gjuhësore, kulturore dhe letrare (Evidenca-10-Rregullore e Departamentit).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, rezulton se Plani Strategjik i Zhvillimit (2020-2025) i Universitetit “Aleksandër Moisiu” parashikon ofrimin e programeve bashkëkohore të studimit në disiplina të ndryshme si: shkenca sociale dhe humane, shkenca juridike dhe politike, shkenca ekonomike, shkenca mjekësore dhe shkenca të natyrës, me objektiv përshtatjen e studentëve të diplomuar sipas nevojave të tregut të punës, të territorit dhe të shoqërisë (Evidenca-3-Plani Strategjik UAMD 2020-2025).</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Gjuhëve të Huaja në përputhje dhe në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UAMD, të cilat kanë përcaktuar qartë fushat dhe drejtimet akademike të institucionit (Evidenca nr.2 - Statuti UAMD; Evidenca-4-Rregullore UAMD 2018; Evidenca-7-Rregullore FE 2019).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Edukimit, “UAMD”, i cili ofron programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” ka një numër total dyzet e shtatë (47) personel akademik, nga të cilët, njëzet e dy (22) personel akademik efektiv, (PAE); njëzet e pesë (25) personel akademik me kontratë (PAK) dhe (1) personel ndihmës akademik. Profesorati efektiv (PAE) i Departamentit të Gjuhëve të Huaja për vitin akademik 2022-2023, përbëhet nga (4) Profesorë të Asociuar; (13) Doktorë të Shkencave; (4) MSc dhe një (1) personel ndihmës akademik. Përsa i përket kualifikimeve të personelit akademik me kontratë, GVJ konstaton se</p>

	për vitin akademik 2022-2023 është deklaruar një (1) staf akademik (PAK) me titullin shkencor Profesor Doktor; një (1) Doktor dhe (20) Master i Shkencave (Evidencë 352 - Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze, Tabela 1.3).
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstaton se fusha e përgjithshme e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” shtrihet në lëmin e edukimit, studimeve kulturore dhe letrare, kërkimit shkencor në gjuhësi, ndërsa ajo specifike ka si qëllim përgatitjen e profesionistëve në gjuhën gjermane dhe angleze, ofrimin e studimeve të thelluara në mësimdhënie dhe mësimnxënie, formimin profesional në fushën e edukimit “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”. Kjo veprimtari është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Edukimit dhe Departamentit të Gjuhëve të Huaja që ofron këtë program studimi. Ky department ka hartuar strategjinë e zhvillimit 2020-2025, ku evidentohet se kjo njësi bazë ofron programe studimi në përshtatje të vizionit të saj me fokus përgatitjen e ekspertëve në mësimdhënie dhe rritjen e efektivitetit të kërkimit shkencor. (Evidenca-7-Rregullore FE 2019; Evidenca-10-Rregullore e Departamentit; Dok. Shtesë - pika 11- Rregullore e programit të studimit Gjuhe Gjermane dhe Angleze). Programi i studimit ofrohet me 180 kredite, sipas sistemit (ECTS), realizohet me kohë të plotë në tre (3) vite akademike dhe i përket nivelit (6) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). GVJ konstaton se kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit përmban veprimtaritë formuese të kategorive (A-E) sipas VKM 41, 2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të”, me lëndët përkatëse të cilat janë të kodifikuara dhe përmbajnë kreditet respektive të tyre (Evidencë 352 - Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze-Tabela 9; Evidenca-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze.pdf). Referuar dokumentacionit në Dosjen e Vetëvlerësimit, GVJ konstaton se institucioni ka kryer regjistrimin e formës së diplomës dhe Supplementit të saj në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, (QSHA) me numrin unik të identifikimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” UAMD-BCH-60231-GJGA (Evidenca-15-Kodifikimi i Programeve UAMD; Evidencë 4- Procedura ASCAL- Urdhër Për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze", të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës).
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë Publik, Universiteti "Aleksandër Moisiu" (UAMD), i cili ofron programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze", nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, të parashikuara në Statutin e</i>

	universitetit. GVJ konstaton se fusha specifike e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze, e cila ka si synim përgatitjen e profesionistëve në gjuhën gjermane dhe angleze, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Edukimit, "UAMD" dhe të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, i cili ofron këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ konstaton se "UAMD" nëpërmjet kuadrit rregullator të brendshëm ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit dhe marrjes së përgjegjësive përkatëse, (Evidenca-10-Rregullore e Departamentit; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018; Evidenca-7-Rregullore FE 2019). GVJ evidenton realizimin e analizës së vazhdueshme të punës së njësive mbështetur në raportet institucionale dhe në analizën vjetore të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, për programin e studimit edhe për veprimtarinë mësimore-shkencore (Evidenca-65- Analiza Vjetore e Njesise Baze per Programin 2021-2022; Evidenca-44-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022; Evidenca 10. Dokumentacion shtesë - Raporti vleresimit per programin e studimit).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ konstaton se UAMD ka nënshkruar 37 marrëveshje ndërkombëtare ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus + dhe mobilitetit. Në nivel institucioni, 'UAMD' ka nënshkruar në total 113 marrëveshje bashkëpunimi vendase dhe të huaja me disa institucione homologe si: universitete, kolegje universitare, institute kërkim zhvillimi, si edhe të kategorisë së shërbimeve publike rajonale si: Bashki, Spital, por edhe subjekte jopublike si : qendra edukative të biznesit, fondacione, kompani udhëtimesh etj (Evidenca-49-Marrëveshjet e bashkëpunimit). GVJ konstaton se janë realizuar 19 mobilitete të studentëve nga Fakulteti i Edukimit (Evidenca-114-Mobilitete të Studentëve) dhe 51 mobilitete të personelit akademik (Evidenca-64-Mobilitetet e Stafit Akademik FE).

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka vendosur 31 marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata bashkëpunuese partnere, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj për zhvillimin e praktikave mësimore. Këto institucione konsistojnë në: agjensi të shërbimeve publike vendore, institucione publike kombëtare, universitete vendase dhe të huaja, institute kërkimore, kompani biznesi, fondacione dhe qendra edukative (Evidenca-49- Marrëveshjet e bashkëpunimit). Gjithashtu UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me “Zyrën vendore Arsimore” Durrës, në funksion të zhvillimit të praktikave mësimore për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Referuar informacionit në RVB dhe dokumentacionit përshkruar në DVV, GVJ konstaton se Departamenti Gjuhëve të Huaja harton raporte analitike për përfitimin nga zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, (Dok.shtesë.pika 8, Raport Analitik rreth përfitimeve nga marreveshjet kombetare dhe nderkombetare).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka ndërtuar mjaftueshëm marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, të cilat shtrihen në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto marrëveshje janë zbatuar me efekt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve, si dhe zhvillimin e praktikave mësimore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p style="text-align: center;">Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, me Ligjin nr. 80/2015, me VKM nr.41, dt.24.01.2018 dhe me Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve</p>



<p>programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>(ECTS). Programi është organizuar në tre vite akademike me 60 kredite secili , i ndarë në lëndë dhe module sipas kategorive. (Evidenca nr.16 - Për elementët e programit të studimit; Evidenca nr.34 Dosja e plotë e programit të studimit pas riorganizimit.)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar GVJ konstaton që programi i studimit synon formimin e specialistëve në fushën e metodikës së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj, specialistë të mësimdhënies së gjuhës gjermane, specialistë të përkthimit duke i pajisur me njohuri mbi gjuhën, kulturën, qytetërimin, letërsinë gjermane, didaktikën, përkthimin që u mundësojnë profesionalizëm në specialitetet mësues, përkthyes/interpret, kritik letrar, udhërrëfyes turistik. Këto njohuri paraqiten në nivel të përparuar dhe synojnë nxitjen e të menduarit kritik dhe aftësimin e kërkimit shkencor të studentit. Programi ka për objektiv formimin gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, aftësimin për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara në fushën e mësimdhënies e të formimit gjuhësor. Duke gjykuar nga përbërja e planit mësimor, reflektimi i tij në programet lëndore, nga literatura shoqëruese dhe nga konstatimet gjatë vizitës, mund të thuhet se programi aplikon në praktikë synimet e shprehura në rregulloren përkatëse. Programi është hartuar për të ofruar njohuri të thelluara dhe për të zhvilluar kompetencat dhe aftësi si nga ana teorike ashtu edhe praktike. Ky formim siguron aftësitë bazë të studentit, i cili synon ndjekjen e kurseve më të përparuara studimi në ciklin e dytë. (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, neni 43,61; Evidenca nr.34 - Dosja e plotë e programit të studimit pas riorganizimit; Evidenca nr.7 - Rregullore e FE, neni 41; Dok.shtesë:Evidenca - Rregullore e programit të studimit, nenet 6,7.)</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV , në mënyrë specifike plani mësimor programit të studimit, konstatohet se programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, me lëndë dhe module të grupuara sipas kategorive të përcaktuara, me kreditet përkatëse , të specifikuar edhe në rregulloren fakultetit (Evidenca nr.7 - Rregullore e FE, neni 62), në zbatim të Vendimit Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, duke mos pasqyruar ndryshimet e përcaktuara në Vendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018”, ku emërtimi lëndë bazë në kategorinë A ndryshon në lëndë të përgjithshme. Më poshtë janë kreditet dhe përqindjet për secilën kategori, të pasqyruara në planin mësimor: -Lëndë bazë A - 36 kredite, 20 %</p>

	<p>-Lëndë karakterizuese B - 94 kredite, 52%</p> <p>-Lëndë ndërdisiplinore/ integruese C - 24 kredite, 13 %</p> <p>-Lëndë plotësuese D – 20 kredite, 11%</p> <p>-Detyrimet përmbyllëse E – 6 kredite, 3%</p> <p>(Evidenca nr.36 – Plani mësimor për programin e studimit)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga GVB GVJ konstaton se rregullorja e praktikës dhe plani mësimor i programit të studimit e ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse. Praktika mësimore shtrihet në tre semestra, e ndarë me orë që realizohen në auditor dhe orë që realizohen në institucione arsimore. (Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit; Evidenca nr.113 – Vendim nr.26 për Ndryshimin e kurrikulës për programet që ofrojnë praktika mësimore; Evidenca nr.116 – Rregullore e praktikës, neni 10; Evidenca nr 118 – Dosja e plotë e praktikave, pika 4; Evidenca 63 – Marrëveshje bashkëpunimi me DAR.)</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit e ka të përcaktuar formën e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimin, të cilat realizohen në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MAS dhe vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”(Evidenca nr.16 - Për elementët e programit të studimit). Në kreun III të rregullores së UAMD, i cili trajton organizimin e studimeve, neni 40 përcakton formën e studimeve, neni 44 përcakton mënyrën e pranimit në programet e studimeve dhe planifikimin e kuotave. (Evidenca nr.4 – Rregullore e UAMD-së nenet 40, 44) Forma e organizimit të studimeve dhe pranimit i studentëve janë të përcaktuara edhe në rregulloren e fakultetit, në kreun V të kësaj rregulloreje, si edhe në vendimet e senatit. (Evidenca nr.7 – Rregullore FE, kreu V, nenet 41,44,45 ; Evidenca nr.54 – Vendim Senati për kriteret e pranimit të studentëve; Evidenca nr.57 – Shpërndarja e kuotave të pranimit të studentëve)</p> <p>Financimi i UAMD kryhet në përputhje me statutin e tij, sipas të gjitha përcaktimeve të bëra në kreun X të këtij statuti. (Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, Kreu X; Dok.shtesë: Evidenca Projekt buxheti dhe plani financiar.)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në</p>	<p>Referuar DVV dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion gjatë bisedës me dekanen e fakultetit dhe drejtuesen e departmentit, konstatohet që përmbajtja e programit të studimit Bachelor “Gjuhë gjermane dhe Angleze” është e ngjashme me programe të tjera studimi bachelor, të ofruara në të njëjtën fushë studimi, brenda dhe jashtë vendit. (Evidenca nr.34 – Dosja e plotë e</p>

nivel, së paku 70 për qind.	programit të studimit; Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit;Evidenca - Rregullore e Programit të Studimit.)			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit ka kodin e tij përkatës në përputhje me fushën e studimit dhe klasifikimeve të përcaktuara nga MAS. Kodi i programit të studimit është UAMD-BCH-60231-GJGA.(Evidenca nr.15 – Kodifikimi i programeve të studimit në UAMD). Sipas RVB kodifikim u bëhet edhe lëndëve të programit, por GVJ nuk e gjeti të pasqyruar kodin e lëndëve në asnjë dokument, as në planin mësimor dhe as në syllabuse. Konstatimi vjen pas shqyrtimit të dokumentacionit në DVV.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi nuk ofrohet si bashkëpunim ose si program i përbashkët midis disa institucioneve. Ai ofrohet dhe mbulohet tërësisht nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Edukimit, Universiteti “Aleksander Moisiu”, Durrës. (Evidenca – Rregullore e programit të studimit, neni 5 dhe 9; Dosja e plotë e vlerësimit të programit të studimit)			
Konkluzione	<i>Programi i studimit “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë. Ai synon formimin dhe profesionalizmin në specialitetet mësues, përkthyes/interpret, kritik letrar, udhërrëfyes turistik. Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, me lëndë dhe module të grupuara sipas kategorive të përcaktuara, me kreditet përkatëse. Përmbajtja e programit të studimit është e ngjashme me programe të tjera studimi bachelor, të ofruara në të njëjtën fushë studimi, brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës sipas klasifikimeve të përcaktuara nga MAS. Për sa i përket kodeve të lëndëve të programit nuk u gjetën të pasqyruara as në planin mësimor, as në syllabuse, kështu që rekomandojmë pasqyrimin e tyre në dokumentat përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Edukimit si njësi kryesore dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja si njësi bazë. Të dyja këto njësi përmbushin të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me organizimin,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>strukturën akademike, stafin akademik, vlerësimin dhe akreditimin. GVJ konstaton se këto detyrime janë të përcaktuara në statutin e UAMD, rregulloren e programit të studimit, në vizionin dhe misionin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit. Fakulteti ka në përbërjen e tij këto departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Gjuhës Shqipe; • Departamenti i Gjuhëve të Huaja; • Departamenti i Letërsisë; • Departamenti i Pedagogjisë; • Departamenti i Psikologjisë; • Departamenti i Sociologjisë; • Qendra e Edukimit në Vazhdim; <p>(Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, Kreu III; Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD , kreu III; Evidenca nr.7 – Rregullore FE kreu V; Evidenca – Rregullore e programit të studimit, nenet 14,15,17)</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e DVV dhe vizitës në institucion konstatohet nga GVJ se programi i studimit nuk ka parashikuar praktika laboratorike dhe klinike. Për sa i përket praktikave mësimore i ka të përfshira në kurrikul dhe i realizon si pjesë të planit mësimor , duke mos qenë e nevojshme të angazhohet personel ndihmës. (Evidenca nr.36 – Plani mësimor për programin e studimit; Evidenca nr.34 – Dosje e plotë e programit të studimit pas riorganizmit; Dok. Shtesë: Evidenca - Rregullore e programit të studimit, neni 15.)</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e universitetit, të Fakultetit të Edukimit dhe të Departamentit të Gjuhëve të Huaja koordinator i programit të studimit është drejtuesi i departamentit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit. (Evidenca nr.4- Rregullore UAMD; Evidenca nr.7 – Rregullore FE; Evidenca nr.10 – Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja) Ky fakt na u pohua edhe gjatë vizitës në institucion në bisedën e zhvilluar me dekanen e fakultetit dhe drejtuesen e departamentit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Për ecurinë dhe zhvillimin e programit është përcaktuar drejtuesi i departamentit si koordinator programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja si njësi bazë disponojnë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Të gjithë këta elementë janë të përfshirë në rregulloren e fakultetit (Evidenca nr.7 – Rregullore FE, neni 41, 58, 61, 62), të departamentit (Evidenca nr.10 – Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, neni 14,20) dhe atë të programit të studimit (Evidenca - Rregullore e programit të studimit, neni 7,14,15), ku detajohen informacioni mbi programin e studimit, objektivat formuese, karakteristikat e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se programi i studimit përmban planin mësimor, në të cilin paraqitet emërtimi i veprimtarisë formuese, kategoria e veprimtarisë A - C, viti dhe semestri, në të cilin zhvillohet lënda, numri i krediteve, orët mësimore në javë, orë të studimit në auditor dhe të studimit individual, si edhe totali i orëve mësimore (Evidenca nr.36 – Plani mësimor për programin e studimit; Evidenca nr.34 – Dosje e plotë e programit të studimit pas riorganizmit; Dok.shtesë: Evidenca - Rregullore e programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit, fakultetit, departamentit dhe programit të studimit gjenden të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, siç janë kriteret e pranimit në programin e studimit, transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve. (Evidenca nr.4- Rregullore UAMD, neni 44, 56; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, neni 45, 57, 58 , 60; Evidenca nr.10 – Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, neni 17; Dok.shtesë :Evidenca - Rregullore e programit të studimit, neni 23; Evidenca nr.54 – Vendim senati për kriteret e pranimit të studentëve; Evidenca nr.56 – Kriteret e transferimit të studimeve) Veçori e këtij programi studimi është vlerësimi i njohurive bazuar në sistemin shqiptar dhe atë amerikan të notës, për t'u ardhur në ndihmë studentëve të cilët duan t'i transferojnë studimet e tyre jashtë vendit. (Evidenca 39 – Suplementi i diplomës)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e</p>	<p>Referuar DVV GVJ konstaton se programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore të secilës lëndë, të cilat janë të formatit të përcaktuar dhe miratuar nga MAS. Syllabuset kanë në përmbajtjen e tyre të gjithë komponentët e nevojshëm si emërtimin e lëndës, ngarkesën e saj në kredite, numrin e orëve, objektivat e lëndës, konceptet themelore, temat dhe kalendarin javor,</p>

laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	format e kontrollit të dijeve dhe literaturën përkatëse. Në to mungon vetëm kodi i lëndës.(Evidenca nr.36 – Plani mësimor për programin e studimit; Evidencat : Syllabuse të lëndëve në DVV)			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Bazuar në dokumentacionin përkatës në DVV , në RVB dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit, i ofruar për herë të parë në vitin akademik 2014-2015 është riorganizuar në vitin 2018 dhe është vazhdimisht objekt përmirësimi dhe përditësimi. (Evidenca nr.115 – Argumentimi i riorganizimit të kurrikulës së programit të studimit; Evidenca nr.113- Vendim nr.26 për ndryshimin e kurrikulave te programet që ofrojnë praktika mësimore; Evidenca nr.112 – Urdhër nr.20 për ndryshimin dhe përshtatjen e kurrikulave; Evidenca nr.37 – Ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit; Evidenca nr.34 – Dosja e plotë e programit të studimit pas riorganizimit.)			
Konkluzione	Në rregulloren e fakultetit, departamentit dhe atë të programit të studimit përfshihet i gjithë informacioni mbi programin e studimit, objektivat formuese, karakteristikat e tij, mbi kriteret e pranimit të studentëve, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, si edhe informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve me të gjithë komponentët e nevojshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës si plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve GVJ konstaton se veprimtaritë mësimore, lëndët dhe praktikat, shpërndarja dhe përmbajtja e tyre bëjnë të mundur që studentët të thellojnë njohuritë, dijet , aftësitë dhe kompetencat profesionale për studime të mëtejshme në nivel master si edhe për punësim , në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Evidenca nr. 34 - Dosja e plotë e programit të studimit pas riorganizimit; Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit; Evidenca nr.23 – Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit, pika 2.1.1, 2.1.2; Evidenca Rregullore e programit të studimit)

<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se në planin mësimor gjendet një shpërndarje e drejtë e lëndëve në vite e semestra, në orë mësimore në auditor dhe individuale, me vlerësimet përkatëse në kredite. (Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit.) Si rrjedhojë bëhet i mundur realizimi i objektivave të programit të studimit, siç janë përgatitja e specialistëve me dije të thelluara në formimin profesional, të specialistëve në fushën e metodikës së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj specialistë të mësimdhënies së gjuhës gjermane në të gjithë nivelet e arsimit parauniversitar (Evidenca nr.23 – Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit). GVJ ka konstatuar se në pikën 2.1 të këtij plani evidentohet fakti që programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane dhe Angleze mundëson zhvillimin profesional për mësuesit e gjuhës angleze, të interesuar në përdorimin e gjuhës gjermane, në punë, apo kontekste akademike, gjë që bie ndesh me linjën e ndërtimit të planit mësimor dhe me objektivat kryesore të programit të studimit. Detajet mbi këtë konstatim gjenden në kriterin 1 të standardit III.4 të RVJ.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në bisedën e zhvilluar me drejtuesen e departamentit dhe dekanen, pasi u vu në dukje ky konstatim nga GVJ, na u pohua që programi i studimit synon formimin e specialistëve të mësimdhënies së gjuhës gjermane.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstaton, se struktura e programit është organizuar në përputhje me profilin e programit, me synim formimin e specialistëve të gjuhës gjermane, duke marrë njohuri të konsiderueshme edhe në gjuhën angleze. (Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit; Dok.shtesë: Evidenca Rregullore e programit të studimit) Gjithashtu, struktura e programit, lëndët dhe raporti teori – praktikë është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kjo reflektohet edhe në mundësitë e studentëve për mobilitete. (Evidenca nr. 34 - Dosja e plotë e programit të studimit pas riorganizimit)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton, se në planin mësimor të këtij programi studimi pasqyrohet qartë ndarja sipas veprimtarive formuese si edhe raporti midis formimit teorik dhe atij praktik, të cilat mundësojnë realizimin e objektivave si edhe u krijojnë mundësinë studentëve jo vetëm për mobilitete dhe transferim studimesh brenda dhe jashtë vendit në programe të ngjashme studimi, por edhe për punësim në përfundim të studimeve. (Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit; Evidenca nr.56 – Kriteret e transferimit të studentëve; Evidenca nr.114 – Mobilitete të studentëve; Evidenca nr.23 – Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit.)</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe bisedës me stafin e angazhuar në programin e studimit gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që një pjesë e syllabuseve përditësohet në përmbajtjen e tyre në mënyrë të vazhdueshme, me synim dhënien e njohurive dhe</p>

<p>marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>kompetencave të nevojshme si edhe përputhjen me kërkesat e tregut. Me gjithë përpjekjen për përditësim dhe përmirësim të programeve të lëndëve vihet re që në një pjesë mjaft të konsiderueshme të lëndëve, gati në gjysmat e tyre, literatura bazë është e vjetër në kohë, gjë që pengon marrjen e kompetencave të nevojshme në përputhje me zhvillimet bashkëkohore dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Si rrjedhojë është domosdoshmëri përditësimi i literaturës si asaj bazë edhe asaj ndihmëse me literaturë të viteve të fundit (Evidencat-Syllabuse të lëndëve të programit të studimit; Biseda me stafin akademik)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga GVJ konstatohet se përmbajtja e kurrikulës së programit të studimit garanton përfitimin e dijeve specifike si dhe aftësive e kompetencave të synuara për ciklin e parë të studimeve.(Evidenca nr. 36 - Plani mësimor për programin e studimit.) Lëndët e programit të studimit ofrojnë njohuri në të gjitha fushat e nevojshme për të përgatitur specialistë të gjuhës gjermane në përputhje me kërkesat e tregut të punës. (Evidenca nr. 34 - Dosja e plotë e programit të studimit pas riorganizimit; Evidenca nr.23 – Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e DVV konstatohet që përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë, pasi përveç formimit bazë dhe shkencor ofron dhe formim profesional në përshtatje me kërkesat e tregut, duke lehtësuar punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve në pozicione të ndryshme pune, si mësues i gjuhës gjermane, përkthyes i gjuhës gjermane dhe / ose angleze, në media, në fushën e turizmit etj. (Evidenca nr.23 – Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit; Evidenca nr.36 - Plani mësimor për programin e studimit.)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura e programit të studimit, organizimi dhe përmbajtja e tij bëjnë të mundur marrjen dhe thellimin e njohurive, duke u krijuar studentëve mundësinë për të vijuar studime të mëtejshme, për të transferuar studimet në institucione të tjera brenda e jashtë vendit, për mobilitete, për t'iu përshatatur më së miri kërkesave të tregut për punësim në fusha të ndryshme. Për të realizuar këto objektiva është i nevojshëm përditësimi dhe përmirësimi i programeve të lëndëve. Në këtë pikë GVJ rekomandon përditësim të literaturës me literaturë të viteve të fundit, gjë që nuk konstatohet në të gjitha syllabuset e lëndëve.</i></p> <p><i>GVJ konstaton një mospërkim të ndërtimit të planit mësimor dhe të objektivave të programit të studimit me vizionin e tij të paraqitura në Planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit, ku thuhet që ky program studimi është ideuar për të siguruar diploma me një kualifikim profesional në mësimdhënien e gjuhës angleze, por nga ana tjetër pësha e lëndëve që ofrohen në gjuhën e angleze është shumë e</i></p>

	<i>pakët në raport me ato të gjuhës gjermane , duke e bërë të pamundur realizimin e këtij qëllimi. Ndërkohë gjatë vizitës në institucion na u pohua që programi i studimit synon formimin e specialistëve të mësimdhënies së gjuhës gjermane. Si rrjedhojë GVJ rekomandon të punohet në drejtim të eliminimit të këtyre kundërshtive, në mënyrë që ajo që ofron programi i studimit, vizioni dhe objektivat e tij të përkojnë dhe të jenë në të njëjtën linjë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe Fakulteti i Edukimit, angazhohen vazhdimisht në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, duke lidhur marrëveshje me institucione partnere, duke ruajtur kontaktin me të diplomuarit në këtë program studimi si edhe në organizmin dhe pjesëmarrjen në veprimtari të përbashkëta me aktorë të tjerë të tregut të punës. (Evidenca nr.26 - Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca nr 27 – Shoqata Alumni UAMD; Evidenca nr.28 – Takime alumni; Evidenca nr.49 – Marrëveshje bashkëpunimi) Të gjitha këto marrëdhënie bëjnë të mundur shkëmbimin e mendimeve dhe marrjen parasysh të propozimeve të të gjitha palëve të përfshira, në funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe arritjes së objektivave të tij. (Evidenca nr. 3- Plani strategjik UAMD 2020 - 2025; Evidenca nr.23 - Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit).
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Referuar shqyrtimit të DVV dhe takimit me studentët aktualë të programit të studimit gjatë vizitës në insitucion GVJ konstaton se në procesin e përmirësimit të programit të studimit institucioni përshin edhe studentët dhe strukturat e tyre, të cilët përmes diskutimeve ose anketimeve shprehin mendimet e tyre mbi programin e studimit, marrjen parasysh të të cilave institucioni e reflekton dukshëm. Studentët theksojnë se problemet apo mangësitë që ata kanë vënë në dukje në anketime janë minimizuar dhe kanë gjetur zgjidhje. (Evidenca nr.18 - Rezultate mbi anketimin e studentëve, stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin; Vizita në institucion – takim me studentët). Gjithashtu institucioni mban kontakte me studentët e diplomuar dhe vlerëson dhe merr parasysh sygjerime të tyre mbi përmirësimin e

	programit të studimit. Duhet theksuar që Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës zhvillonte një agjendë të gjerë në drejtim të takimeve Alumni (Evidenca nr 27 – Shoqata Alumni UAMD; Evidenca nr.28 – Takime alumni).			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar DVV, planit strategjik të UAMD, planit strategjik të programit të studimit dhe takimit me stafin , me drejtuesen e departamentit dhe dekanen e Fakultetit të Edukimit konstatojmë bashkëpunime me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve të ndryshme, konferencave, projekteve dhe bashkëpunimeve me synim përmirësimin e programit të studimit (Evidenca nr. 3- Plani strategjik UAMD 2020 - 2025; Evidenca nr.23 - Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit; Evidenca nr.123 – Marrëveshje bashkëpunimi për programin Erasmus; Takimet në institucion).			
Konkluzione	<i>Institucioni angazhohet vazhdimisht në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut duke bashkëpunuar ngushtë me institucione kërkimore e shkencore, publike e private duke lidhur marrëveshje me institucione partnere, duke ruajtur kontaktin me të diplomuarit në këtë program studimi , duke përfshirë studentët dhe strukturat e tyre në shprehjen e mendimeve të tyre përmes diskutimeve ose anketimeve dhe duke vlerësuar dhe reflektuar mbi mendimet dhe sygjerimet e dala nga këto bashkëpunime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	GVJ konstaton bazuar në dokumentacionin shoqërues në DVV dhe informacionin në RVB, se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është i organizuar me 180 kredite sipas sistemit “European Credit Transfer System, (ECTS), i cili realizohet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>me kohë të plotë për tre vite akademike dhe i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), (Evidencë nr. 3 Vendim Senati Per riorganizimin e programit Bachelor ne "Gjermanisht Anglisht" (UAMD); Evidencë nr.1-Procedura ASCAL - Shkresë Per miratimin e riorganizimit te programeve te Fakultetit te Edukimit, UAMD).</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” ofrohet në përputhje VKM 41/2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë format e mësimdhënies”, ku rezulton se plani mësimor i programit të studimit është i përshtatur sipas kuadrit të përgjithshëm të veprimtarive formuese (A-E) të ndara në: leksione dhe seminare, shoqëruar me numrin përkatës të krediteve, orëve të studimit individual dhe orët në auditor. Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” nuk përmban orë laboratike ose ushtrime (Evidenca-16-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-datë-24.1.2018). Sipas planit mësimor në kategorinë (D) të lëndëve plotësuese janë përfshirë dy lloje praktikash: praktikë aktive dhe praktikë dëgjimore me nga (4) katër kredite secila (Evidencë 352 Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze- Tabela 9 - Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E; Tabela 10 - Plani Mësimor për Programin Gjuhë Gjermane dhe Angleze). GVJ konstaton se për këtë program studimi, sipas rregullores së Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Neni 22, (pika 6/c) si forma të vlerësimit të dijeve janë parashikuar format e mësimdhënies si detyrat e kursit, esetë ose projektet, të cilat marin 10% të vlerësimit përfundimtar të lëndës të cilat reflektohen në syllabuset e lëndëve (Evidenca-10-Rregullore e Departamentit; Evidenca-23-Plani Strategjik i Zhvillimit te Programit Gjuhë Gjermane dhe Angleze; Evidenca 150-350, Syllabus-et e Lëndëve të Programit; Evidenca-10- Dokumentacion shtesë - Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze). GVJ konstaton se orët e hapura të mësimit janë parashikuar në rregulloret e institucionit dhe ndiqen sipas planit të veprimtarisë së Departamentit të Gjuhëve të Huaja (Evidenca-75-Rregullore e Organizimit të Konferencave dhe Veprimtarive Shkencore UAMD-Pika IV; Evidenca-66-Lista e Leksioneve të Hapura 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimdhënies.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në DVV dhe vizitës në institucion, konkretisht nga takimi me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze, GVJ konstaton se personeli akademik ndjek programet e shkëmbimit në universitete partnere dhe ushtron veprimtarinë mësimdhënëse në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Programit “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, ku evidentohet se nëntë (9) personel akademik nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja kanë kryer mobilitet stafi për qëllime</p>

	<p>mësimdhënëse ose trajnimi në disa vende si Rumani, Letoni dhe Hungari. Gjithashtu personeli akademik i FE është angazhuar në dy projekte me financime të huaja “Capacity Building HE” (Dok.Shtesë-pika13- Gjuhe Gjermane dhe Angleze, Drejtoria e Projekteve dhe Marredhenieve me Jashte; Evidenca-64-Mobilitetet e Stafit Akademik FE). GVJ evidenton se personeli akademik dokumenton informacionin mësimor, i cili realizohet në forma audio-vizuale nëpërmjet infrastrukturës dhe hapësirave digjitale që Fakulteti i Edukimit ofron, të tilla si: salla e internetit, salla për praktikën lëndore/profesionale, laboratorë informatikë dhe biblioteka digjitale U-library (Ebsco). (Evidenca-23-Plani Strategjik i Zhvillimit te Programit Gjuhë Gjermane dhe Angleze; Evidencë - Vizita në institucion; Evidencë 352 Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze- Tabela 16/17).</p> <p>Format e mësimnxënies të tilla si: detyra kursi, ese dhe projekte, janë parashikuar në syllabuset e lëndëve nga titullarët e lëndëve, si një mënyrë që i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve për punën në grup, marrjen e iniciativave individuale, nxitjen e mendimit kritik dhe zbatimin e punëve me karakter aplikativ dhe praktik (Evidenca 150-350, Syllabuset e Lëndëve të programit).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p>	<p>Referuar të dhënave në RVB dhe materialeve informuese në DVV, GVJ vëren se personeli akademik, lidhur me përmirësimin e kompetencave didaktike të tyre, mbështetet nga “UAMD” kryesisht në drejtim të pjesëmarrjes në programet evropiane të shkëmbimit në universitete partnere dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, ku konstatohet se ky departament ka realizuar gjithsej pesë (5) konferenca shkencore ndërkombëtare, nga të cilat (1) një është realizuar përgjatë periudhës kohore 2020-2023, për të cilin kryhet vlerësimi i jashtëm i cilësisë për programin e studimit. Institucioni ka mbështetur PA duke mundësuar botimin e punimeve të tyre në revistën shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) të UAMD pa detyrime financiare. Institucioni gjithashtu ka financuar një projekt të DGJH me titull “Ankthi profesional në mësimdhënie”</p> <p>Përsa i përket programeve të mobilitetit, GVJ konstaton se nëntë (9) Personel Akademik nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja kanë qenë pjesë e programeve të shkëmbimeve në Rumani, Poloni, Letoni dhe Hungari. Po ashtu, evidentohet se ka patur dy (2) mobilitete hyrëse (incoming) (Dokumentacion shtesë-pika 13-Gjuhe Gjermane dhe Angleze Drejtoria e Projekteve dhe Marredhenieve me Jashte; Evidenca-64-Mobilitetet e Stafit Akademik FE; Evidenca-79-Konferencat e Organizuara nga Njësia Bazë). GVJ konstaton se personeli akademik mbështetet nga pikëpamja e infrastrukturës për të siguruar përmirësimin e kompetencave didaktike të tyre, pasi FE ofron</p>

	<p>disa burime didaktike në formatin fizik dhe elektronik si: kompjutera (desktop), akses në llogaritë elektronike në domain-in institucional e.mbiemër@uamd.edu.al, biblioteka digjitale dhe fizike, mjete didaktike të teknologjisë së avancuar (Evidencë - Vizita në institucion; Evidencë 352 Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze- Tabela 16/17). Në funksion të mbështetjes së personelit akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike, UAMD ka ngritur Qendrën e Edukimit në vazhdim, e cila është në përbërje të strukturës së FE (Evidenca-9-Organigrama FE, 2019).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është i formuar dhe specializuar në gjuhën angleze dhe gjermane (Evidenca nr. 16 CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit). Bazuar tek dokumentacioni përcjellë përmes DVV dhe shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” për vitin akademik 2022-2023 është në total njëzet e dy (22), nga të cilët (14) personel akademik efektiv, (PAE) dhe (8) personel akademik me kontratë (PAK). PAE i angazhuar në programin e studimit, përbëhet nga (2) Profesorë të Asociuar; (8) Doktorë të Shkencave; (3) MSc dhe një (1) docent. Përsa i përket kualifikimeve të personelit akademik me kontratë, GVJ konstaton se për vitin akademik 2022-2023 është deklaruar një (1) staf akademik (PAK) me gradën ‘Doktor i Shkencave’ dhe (7) Master i Shkencave (Dok. Shtesë – Evidencë 5, Tabelat 6.1-6.3). PA siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes studentëve, të cilat janë paraparë në Statutin e UAMD, Neni 51; në Marrëveshjen për orarin e punës; në Kodin e Etikës (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018; Evidenca-50-Marrëveshje për Kohën Vjetore të Punës; Evidenca-5-Kodi i Etikës UAMD).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ evidenton dhe vlerëson se DGJH ka kryer një proces të vlerësimit të programit të studimit për vitin akademik 2021- 2022, i cili përmban analizën me përparësitë dhe mangësitë për implementimin e tij. <i>Por, GVJ rekomandon që të tilla raporte të përmbajnë informacione që janë rezultat i përdorimit të indikatorëve dhe instrumentave matës të hartuar dhe miratuar nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të brendshëm, në mënyrë që të përfshijnë edhe studentët me këshillat dhe rekomandimet e tyre</i> (Dok. Shtesë – pika 10-Raporti vlerësimit per programin e studimit). GVJ konstaton se formulari i vlerësimit të studentëve për programin e studimit i referuar në RVB, përkon me programin e studimit “Gjuhë Angleze” (Evidenca-67-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit). <i>GVJ rekomandon që institucioni të kryejë dhe të raportojë nga strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dokumentacion të</i></p>

	<i>plotë dhe të përditësuar për vlerësimin e brendshëm (Evidenca-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin, 2018- 2019).</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UAMD mbështetur në Rregulloren për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ka ngritur struktura të posaçme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë në nivel institucional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies si: 1. “Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit” (KPGSCIPS), në përbërje të të cilit është përfshirë një (1) student; 2. “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, (NjSBC) e strukturuar në nivel fakulteti; 3. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC) 4. Qendra e Edukimit në vazhdim e cila është strukturë brenda FE dhe trajnon personelin akademik për zbatimin e metodave të reja në mësimdhënie. Misioni i NjSBC-së në nivel fakulteti përqendrohet rreth aplikimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë eksplicite procesin e mësimdhënies, të nxënit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studentëve me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me në qendër studentin (Evidenca-17-Rregullorja për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 8/9).			
Konkluzione	<i>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) e realizon procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin duke rekrutuar personel akademik të paisur me grada shkencore të nevojshme për mësimdhënien në ciklin e parë të studimeve për programin Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, të cilët përdorin metoda interaktive të mësimdhënies që nxisin mendimin krijues dhe atë kritik. Gjithashtu GVJ konstaton se realizohen programe ndërkombëtare të mobilitetit për personelin akademik dhe studentët, si edhe janë ngritur strukturat e sigurimit të cilësisë së brendshme, ku janë përfshirë studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të	Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB-së, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>aftësive profesionale për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, përcaktohen në kuadrin rregullator të brendshëm të institucionit të tilla si: Rregullorja e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Rregullorja e Fakultetit të Edukimit, por edhe në rregullore të posaçme si Rregullorja e Programit të studimit Bachelor “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, të cilat parashikojnë se procedurat dhe kriteret e vlerësimit, përcaktohen në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve në orën e parë të zhvillimit të kursit. Këto rregullore kanë unifikuar sistemin e vlerësimit të studentit, ku forma e vetme e kontrollit të dijes është provimi me shkrim, që realizohet në formatin e provimit të ndërmjetëm, në javën e shtatë ose të tetë të strukturës mësimore dhe atij final në përfundim të lëndës. GVJ eidenton se vetëm 10 % e vlerësimit përfundimtar të studentëve i kushtohet detyrave të kursit ose projekteve sipas programit të kursit të miratuar. (Evidenca-7-Rregullore FE 2019, Neni 66; Evidenca-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze, Neni 17; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 62).</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV dhe vizita në institucion, konkretisht takimi me studentët dhe personelin akademik se studentët informohen me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. GVJ eidenton se në Nenin 62 të Rregullores “UAMD” dhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, shprehen qartë format e vlerësimit të dijes dhe bërja publike e tyre (Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 62; Evidenca 150-350 Syllabuset e lëndëve).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, se në tabelën 15 për format e kontrollit të njohurive janë përcaktuar pjesët në përqindje për çdo formë vlerësimi, ku vërehet se provimi përfundimtar zë 50% të totalit të vlerësimit përfundimtar; testimi gjatë vitit (provimi i ndërmjetëm) zë 40 % dhe zhvillohet në javën e shtatë ose të tetë të strukturës mësimore; detyrat e kursit, projektet, është zënë 10 % të vlerësimit përfundimtar. GVJ konstaton se kjo ndarje mes kategorive të vlerësimit është reflektuar edhe në syllabuset e lëndëve, të cilët përcaktojnë edhe kategorinë për frekuentim të detyrueshëm të lëndës, e cila nuk duhet të jetë më pak se 75% dhe nuk zë peshë në vlerësimin përfundimtar të lëndës (Evidencë 352- Tabelat permbljedhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze – Tabela 15 per format e kontrollit te njohurive; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 62/66; Syllabuset e lëndëve,Evidenca 150-350).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Evidentohet nga GVJ se Statuti “UAMD” (Neni 89, pika c/ç) parashikon përfshirjen e studentëve në proceset e vendimmarrjes të institucionit, në nivel njësie bazë dhe kryesore, si edhe të shprehin vlerësimin e tyre për personelin akademik dhe cilësinë e programeve të studimit (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018). GVJ e gjen të</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>aplikueshëm këtë parashikim përpara i takon përfshirjes së studentëve në Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit (KPGSCIPS), si dhe përfshirjes së tyre në anketimet e studentëve për vlerësimin e personelit akademik. Por GVJ konstaton se raporti për vlerësimin e programit të studimit është realizuar më të dhënat e grumbullura në vitin 2018-2019 në nivel institucional, të cilat nuk janë specifike për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”(Evidenca-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin, 2018- 2019; Dok. Shtesë pika 9-Raporti i Vleresimit te Brendshem te Fakultetit te Edukimit). Vlerësimi për programin e studimit kryhet nga departamenti i gjuhëve të huaja. GVJ konstaton se studentët nuk përfshihen në këtë proces, por konstatohet analiza e aspekteve të punës mësimdhënëse dhe shkencore të personelit akademik, ku përfshihet analiza SWOT për programin e studimit (Dok. Shtesë-pika 10-Raporti vleresimit per programin e studimit).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton nga informacioni në RVB dhe dokumentacioni bashkëlidhur në DVV, se UAMD ka mundësuar disa burime me qëllim përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të tilla si infrastruktura në funksion të programit të studimit, shfrytëzimi i bibliotekës on-line https://ulibrary.rash.al/, sigurimi i cilësisë së mësimdhënies e parashtruar në Politikat e Cilësisë të Fakultetit të Edukimit. Përpara i përket kërkesave të punëdhënësve, GVJ konstaton se departamenti i gjuhëve të huaja ka kryer studimin e tregut të punës si një analizë e mëvetësishme dhe specifike në çeljen e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” (Evidenca-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi; Evidenca-71-Infrastruktura në Funksion të Programit të Studimit; Evidenca-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE; Dok-shtesë-pika 12- Studimi i tregut per programin e studimit). GVJ konstaton se mësimdhënia dhe kërkimi shkencor janë prioritet të punës së Departamentit të Gjuhëve të Huaja, i cili ka identifikuar disa objektiva kryesore: zhvillimi i orëve praktike mësimore për studentët; pajisja e studentëve me njohuri bashkëkohore; angazhimi i studentëve në problematikat aktuale; përfshirja aktive e studentëve në procesin e të mësuarit, nëpërmjet nxitjes së të menduarit kritik; orientimi i studentëve drejt kërkimit shkencor (Evidenca-12-Strategjia e Departamentit te Gjuheve te Huaja, 2022-2025). Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike është vënë në funksion Qendra për Edukim të vazhdueshëm, në Fakultetin e Edukimit, e cila kryen cikle periodike trajnimesh për personelin akademik.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ evidenton nga monitorimi i dokumentacionit fizik në DVV dhe nga vizita në institucion se “UAMD” ka krijuar kuadrin rregullator të</p>

	<p><i>brendshëm të institucionit si: "Rregullorja e Universitetit "Aleksandër Moisiu", "Rregullorja e Fakultetit të Edukimit", si edhe rregullore të posaçme si "Rregullorja e Programit të studimit Bachelor "Gjuhë Gjermane dhe Angleze", ku përcaktohen qartë procedurat dhe kriteret e vlerësimit të studentit, të cilat reflektohen edhe në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve në orën e parë të zhvillimit të kursit. UAMD mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, nëpërmjet strukturave të posaçme me në fokus edukimin dhe përmirësimin e teknologjisë në mësimdhënie.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" realizohet sipas kategorive të vlerësimit në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL". Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij programi studimi është rezultat i tre treguesve: 1-vlerësim i vazhduar nëpërmjet zhvillimit të projekteve, përgatitjes së eseve dhe detyrave të kursit, i cili mbart 10% të vlerësimit përfundimtar; 2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit ose vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës nëpërmjet provimit të ndërmjetëm që zhvillohet në javën e shtatë ose të tetë të strukturës mësimore dhe mbart 40% të vlerësimit total, 3-vlerësimi me anë të provimit final zë 50 % të vlerësimit përfundimtar. Pëveç vlerësimit nëpërmjet projekteve/eseve/detyrave të kursit, forma e vetme e kontrollit të dijeve është provimi me shkrim (Evidenca-7-Rregullore FE 2019, Neni 66). Sistemi i pikëzimit të tyre është reflektuar në syllabuset e lëndëve, ku është përcaktuar gjithashtu kategoria e frekuentimit të detyrueshëm të lëndës, e cila nuk duhet të jetë më pak se 80% dhe nuk zë peshë në vlerësimin përfundimtar të lëndës (Evidencë 352- Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze – Tabela 15 per format e kontrollit te njohurive; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 62/66; Syllabuset e lëndëve, Evidenca 150-350).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat</p>	<p>Referuar informacionit në RVB, dokumentacionit mbështetës, si edhe takimit me personelin akademik, GVJ konstaton se me qëllim shmangien e abuzivitetit dhe rritjen e transparencës, institucioni vë në</p>

shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	përdorim sistemin elektronik Cleanscore në testime (Evidenca-94-Përdorimi i Cleanscore në Testime).
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ u informua nga takimi me personelin akademik në institucion dhe referuar dokumentacionit në DVV se format e kontrollit të njohurive dhe pikëzimi për to janë parashikuar qartë nga pedagogu në syllabuset e lëndëve në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”. Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij programi studimi kryhet në bazë të shumës së pikëve të grumbulluara përgjatë vitit dhe është rezultat i tre (3) treguesve: 1-vlerësimi i vazhduar, (100 pikë) (zhvillimi i projekteve, eseve, detyrave të kursit); 2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/ vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit: një provim i ndërmjetëm, (400 pikë) 3-vlerësimi me anë të provimit final, (500 pikë). Vlerësimi përfundimtar është i mirëpërcaktuar në fomë tabelare sipas konvertimit të përqindjes, pikëve të grumbulluara, notës dhe të shprehurit me fjalë. Vlerësimi kryhet nga komisioni i provimit, i përbërë nga dy anëtarë, njëri prej të cilëve është titullri i lëndës. (Evidencë 352- Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze – Tabela 15 per format e kontrollit te njohurive; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 62/66; Evidenca 150-350, Syllabuset e lendëve).
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar takimit në institucion me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” shoqërohet me komente dhe këshilla mbi procesin e të nxënit, kryesisht përgjatë vlerësimit të vazhduar, konkretisht për rezultatet në detyrat e kursit, projektet dhe provimet e ndërmjetme për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen, (Dok. Shtesë - Evidenca-11-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze, Neni 22).
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga evidencat e paraqitura në DVV, evidentohet nga GVJ shmangia dhe mos lejimi i plagjiaturës, si dhe mos kopjimi në provime dhe detyra, nëpërmjet identifikimit të studentit pjesëmarrës në provim, ndaljes së përdorimit të mjeteve komunikative osë bazës materiale përveç asaj të lejuar në sallën e provimit, si edhe nëpërmjet parashikimit si shkelje disiplinore dhe të dënueshme të kopjimit ose plagjiaturës (Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 70/ 116; Dok. shtesë- Evidenca-11-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze, Kreu VI).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në	GVJ konstaton nga informacioni i paraqitur në RVB, se rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin e vlerësimit dhe regjistrin e rezultateve, pasi realizohet përlllogaritja e pikëve totale nga titullari i lëndës, i cili më pas ngarkohet në sistemin Pitagora. Rezultatet jepen në bazë të meritës duke reflektuar format e vlerësimit të parashikuara

rregulloret përkatëse.	në syllabusin e lëndës, të cilat u komunikohen studentëve përgjatë zhvillimit të lëndës. Në këtë linjë realizohet konstatimi i rezultateve të provimit të ndërmjetëm, me qëllim sigurimin e transparencës së vlerësimit. Në rastin e provimit përfundimtar është titullari i lëndës i cili përcakton datën dhe orën se ku bëhet shpallja e rezultateve, e cila nuk duhet të jetë më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit (Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 69, pika 7) . GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit nuk është përcaktuar koha e dhënies së rezultateve të provimit, por përmendet vetëm detyrimi për t'u realizuar komunikimi i rezultateve të provimit nga pedagogu. Dok. shtesë - Evidenca-11-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze, Neni 20) .			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>“UAMD”garanton nëpërmjet Rregullores së tij institucionale të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, për të kryer kërkesa për rishikim të vlerësimit në përputhje me Statutin e tij. GVJ konstaton se neni 71 i rregullores “UAMD” parashikon ankimimin e provimeve, ku si procedurë studenti i drejton ankesën me shkrim përgjegjësit të njësisë bazë, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga publikimi i rezultatit. Pasi drejtuesi i njësisë kryesore njihet me ankesën, ai ngre një komision ad-hoc për rishikimin e saj. Rishikimi i tezës nga grupi ad-hoc realizohet në prani të studentit dhe komisionit dhe në rast se rishikimi sjell ndryshim të vlerësimit përfundimtar të notës, atëherë kjo e fundit pasqyrohet në procesverbalin e kursit, (Evidenca-4-Rregullore UAMD 2018). Mënyra e vlerësimit në rastin e ndryshimit të notave të raportuara është parashikuar në rregulloren e programit të studimit, (Dok. shtesë - Evidenca-11-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze, Neni 22).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se “UAMD” ka hartuar një kuadër rregullator të konsoliduar, ku përfshihen rregullore të përgjithshme (të Universitetit, të Fakultetit të Edukimit dhe të posaçme (të programit të studimit) për të garantuar vlerësimin transparent të studentit duke i dhënë studentit të drejtën të realizojë procedurën e ankimimit të notës sipas procedurës të parashikuar në këto rregullore. GVJ evidenton se UAMD ofron mundësinë e vlerësimit nëpërmjet formatit electronic Cleanscore, realizon raportimin e rezultateve të vlerësimit në sistemin e brendshëm “Pitagora” dhe parandalon kopjimin ose plagjiaturën nëpërmjet masave të parashikuara në rregullore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i referencës në DVV për kuadrin e përgjithshëm formues të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” i riorganizuar me ndryshime deri në masën 20%, me Vendim Senati Nr. 57, datë 14.06.2018 dhe miratuar nga MAS me shkresë Nr. 7238/1, GVJ konstaton se veprimtaria formuese e programit të studimit është në përputhje me VKM 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”, për kategorinë “Bachelor”:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndët bazë (A) mbartin 36 kredite ose 20 % nga referenca e detyrimit ligjor (15%-20%) ECTS; - lëndët karakterizuese (B) mbartin 94 kredite ose 52 % nga referenca (50%-55%); - lëndët ndërdisiplinore (C) mbartin 24 kredite ose 13 % nga referenca (12%-15%); - lëndët plotësuese (D) mbartin 20 kredite ose 11% nga referenca (10%-15%); - detyrimet përmbyllëse (E) mbartin 6 kredite ose 3% nga referenca (10%-20%), (Evidenca-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Gjermane dhe Angleze). <p>GVJ konstaton se orët e studimit individual, të cilët përlogaritin veprimtarinë e përgatitjes së punimeve të relacioneve, detyrave të kursit dhe projekteve, (parashikuar në VKM 41/2018) janë përfshirë në planin mësimor të programit të studimit, të shpërndara sipas kategorive seminar dhe leksione, (Evidencë 352- Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze , Tablea 10/11).</p> <p><i>GVJ vëren se, pavarësisht se kuadri i veprimtarive formuese për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është në përputhje për nga ndërtimi me direktivat e udhëzimit Nr.41/2018, plani mësimor i tij, në kategorinë e lëndëve karakterizuese (B) i ka dhënë më shumë prioritet lëndëve të gjuhës gjermane, ku nga 18 lëndë në total që janë parashikuar për këtë kategori, 12 lëndë janë specifike për gjuhën gjermane si: Përdorim i pavarur i gjuhës gjermane I, II; Fonetikë gjermane; Formim gjuhësor gjermanisht; Përdorim i përparuar i gjuhës gjermane I, II; Morfologji gjermane; Sintaksë gjermane; Leksikologji gjermane; Semantikë gjermane; Histori gjermane; Qytetërim gjerman; Medievistikë letrare gjermane dhe Letërsi më e re gjermane. Ndërkohë, GVJ vëren se janë vetëm dy (2) lëndë karakterizuese për gjuhën angleze: Bazat e gjuhës angleze I, II dhe Formim gjuhësor në anglisht I, II. Ndërsa lëndët: Teori përkthimi; Teknika përkthimi; Gjuhësi e përgjithshme dhe Gjuhësi teksti janë të përbashkëta për të dyja gjuhët, gjermane dhe angleze (Evidenca-36-</i></p>

	<p>Plani Mësimor për Programin Gjuhë Gjermane dhe Angleze).</p> <p>Në lidhje me mosbalancimin e ponderimit të përqindjes së krediteve për lëndët në planin mësimor, GVJ, përgjatë vizitës në institucion, mori shpjegimin se në objektivat e Planit Strategjik të Zhvillimit të Programit “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është përcaktuar që ky program studimi synon: të përgatisë specialistë në fushën e metodikës së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj; të përgatisë specialistë të mësimdhënies së gjuhës gjermane në të gjithë nivelet e arsimit parauniversitar të studentëve për gjuhën gjermane. <i>Ndërkohë GVJ konstaton që është parashikuar në Planin Strategjik të tij se programi i studimit parashikon zhvillimin profesional për mësuesit e gjuhës angleze, të interesuar në përdorimin e gjuhës gjermane, në punë, apo kontekste akademike që nuk përkon me kuadrin e veprimtarive të përgjithshme formuese të programit të studimit (Evidenca-23-Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit Gjuhë Gjermane dhe Angleze-Pikat 2.1/2.1.2).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në disa fusha nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndëve bazë me karakter të teknologjisë së informacionit, si “Teknologjia në mësimdhënie” – kategoria (A); lëndë karakterizuese me profil të shkencave humane humane si: “Qytetërim gjerman”, “Medievistikëgjermane-kategoria (B); lëndë ndërdisiplinore/integruese si: “Gjermanishtja përmes mediash”, “Gjermanishte profilesh kulturore”, “Anglisht përmes gjinive letrare” – kategoria (C) lëndë plotësuese me karakter të shkencave të komunikimit si “Përvetësim i gjuhës së dytë”- kategoria (D) (Evidenca-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Gjermane dhe Angleze).
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimit me PA të angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, si edhe syllabuseve të lëndëve në këtë program studim GVJ evidenton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Konkretisht, titullari i lëndës, në përfundim të saj, realizon një përsëritje të koncepteve themelore dhe bën një përmbledhje me efekt orientimi drejt provimit përfundimtar, i cili kontrollon 60% të njohurive të marra në 7 javët e fundit të semestrit dhe 40% të njohurive të marra në 7 javët e para.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të</p>	<p>GVJ konstaton se mësimdhënia realizohet kryesisht mbi bazën e kompetencave, të cilat janë parashikuar në syllabuset e lëndëve në përputhje me rregulloret e brendshme në formën e realizimit të detyrave të kursit, projekteve, eseve, prezantimit të projekteve</p>

<p>zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>semestrale, interaktivitetit në orën mësimore nëpërmjet praktikës dëgjimore dhe praktikë aktive. Programi i studimit me Vendim Senati nr.26/2019 ka pësuar ndryshime në lidhje me praktikën mësimore duke rritur numrin e orëve në dispozicion të kësaj lënde nga 45 në 75 orë në semester, (Evidenca-40- Vendim senati 26 (1) ndryshim në kurrikul praktika; Evidenca-118- Dosja e plote e praktikave për programin Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze).</p> <p>Për të garantuar këtë objektiv realizohet procesi i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. GVJ vëren se kuadri rregullator ka parashikuar 50% të vlerësimit final për këtë kategori, ku vetëm 10% zënë detyrat, esetë, projektet ose punimet për lëndën, (Evidencë 352- Tabelat permbledhese BA Gjuhe Gjermane dhe Angleze – Tabela 15 per format e kontrollit te njohurive; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018, Neni 62/66; Syllabuset e lëndëve, Evidenca 150-350).</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacioni shoqërues në RVB evidentohet nga GVJ realizimi i orëve të hapura nga PAE dhe PAK. Konkretisht në referencë me Raportin e veprimtarive shkencore të Departamentit të Gjuhëve të huaja janë realizuar 15 leksione të hapura në vitin akademik (2021-2022, ku pjesërisht përfshihen edhe tematika mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, (Evidenca-80-Raporti i Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" garantohet nga parashikimet dhe përcaktimet në rregulloren e programit të studimit, strategjinë e zhvillimit të tij dhe planin e veprimtarisë mësimore –shkencore të departamentit të gjuhëve të huaja. Por, GVJ konstaton se plani mësimor i këtij programi studimi reflekton se lëndët për gjuhën gjermane në kategorinë e lëndëve karakterizuese (B) kanë më tepër peshë në kuadrin e përgjithshëm të veprimtarive formuese të tij, pasi janë në një numër shumë të lartë krahasuar me lëndët e gjuhës angleze, (raporti 12/2). GVJ konstaton se ky plan mësimor është pjesërisht i ideuar për të siguruar diploma me një kualifikim profesional në mësimdhënien e gjuhës angleze, sikurse është parashikuar në Planin Strategjik të tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin e studimit në Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, kryhet me provim të përgjithshëm ose punim diplome, parashikuar në rregullore të posaçme si në rastin e Rregullores së Diplomimit, Neni 3/4/5/6, (Evidenca-24-Rregullore e Diplomimit). Kjo rregullore parashikon se studenti duhet të grumbullojë 180 kredite (ECTS) dhe përfiton 6 kredite (ECTS) për këtë detyrim përmbyllës. Në këtë rregullore në Nenin 6, pika 1 “Procedurat e zgjedhjes, përgatitjes dhe mbrojtjes së tezës së diplomës” parashikohet se departamenti me fillimin e semestrit të dytë të studimit, përcakton kriteret dhe studentët që diplomohen nëpërmjet tezës së diplomës (Evidenca-24-Rregullore e Diplomimit). Kjo rregullore nuk përmban pragu e notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome. Referuar këtij përcaktimi, GVJ vëren se në Rregulloren e Departamentit të Gjuhëve të Huaja nuk është specifikuar se cilat janë kriteret për kualifikimin e studentëve për mbrojtjen me punim diplome (Evidenca-10-Rregullore e Departamentit, Neni 28; Evidenca-7-Rregullore FE 2019). GVJ konstaton se pragu i notës mesatare (nota 8) është përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” (Dokumentacion shtesë- Evidenca-11-Rregullore Bachelor Gjuhë Gjermane dhe Angleze). GVJ rekomandon që përcaktimi pragu të notës për diplomim me punim të temës së diplomës duhet të bëhet publik në çdo rregullore që prek veprimtarinë e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar Manualin për punimin e diplomës “Bachelor”, ku janë parashikuar elementë si: udhëheqja e punimit të diplomës nga punonjësit mësimorë- shkencorë të fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore së paku “Master Shkencor” për programet e ciklit të parë “Bachelor”; përgjegjësitë e studentit për punimin e temës së diplomës në lidhje me standardet shkencore dhe etike të parashikuara për provën finale; Procedura e zgjedhjes, përgatitjes dhe mbrojtjes së tezës së diplomës të cilat përcaktojnë se Departamenti, me fillimin e semestrit të dytë të studimit, përcakton studentët që diplomohen nëpërmjet tezës së diplomës, si edhe kriteret për studentët të cilët mund të diplomohen me mbrojtje teze diplome (Evidenca-121-Manual per punimin e diplomës bachelor Fakulteti i Edukimit UAMD , Pika 2). Po ashtu, GVJ evidenton në rregulloren e DGJH se njësia bazë u bën të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të vitit akademik. Drejtuesi i njësisë bazë ngre komisionet e provimit të diplomimit (KPD) për çdo program studimi që mbulon njësi bazë. KPD, nëpërmjet sekretarisë mësimore, u bën të ditur studentëve mënyrën e</p>

	<p>organizimit të provimeve të diplomimit (Evidenca-10-Rregullore e Departamentit Neni 28) Evidenca-24 Rregullore diplomimi, Neni 3/pika 8). Për realizimin e detyrimit përmbyllës të diplomimit studentët e programit Bachelor në Gjuhë Gjermane dhe Angleze kanë mundësi që nëpërmjet dy formularëve, konkretisht 1.-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi. 2.- Kërkesë për Provim Formimi për diplomimin me provim të përgjithshëm e shprehur nëpërmjet kërkesës për t'u regjistruar në provimin/temën e diplomës” të plotësuar, sipas formatit të miratuar, të paktën 2 javë nga data e shpallur nga dekanati për zhvillimin e provimit të diplomimit dhe mbrojtjen e temave të diplomës. Studentët u drejtohen me këto kërkesa kryesekretarit të njësisë kryesore një muaj para përfundimit të semestrit të dytë dhe dy javë pas përfundimit të sezoneve (verë dhe vjeshtë), (Evidenca-32-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi;Evidenca-120-Kerkese per Provim Formimi) Evidenca-10-Rregullore e Departamentit Neni 27,pika C).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ konstaton se për administrimin e mbrojtjes së diplomës, ngrihet një komision i posaçëm/ juria me jo më pak se tre (3) persona (një nga të cilët është udhëheqësi i tezës). Rregullorja e departamentit ka parashikuar se drejtuesi i njësisë bazë, për çdo program propozon ngritjen e një komisioni për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit, të përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij në jo më pak se 20 minuta, (Evidenca-10-Rregullore Departamentit, Neni 30).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Tezat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimorë- shkencorë të njësisë kryesore që kanë titull ose gradë shkencore, (të paktën të një cikli më të lartë), nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore që i përshtaten studimeve të ofruara nga universiteti “Aleksandër Moisiu” dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit. Njësia bazë, me fillimin e semestrit të dytë të studimit, në bazë të mundësive për udhëheqje dhe në përputhje me natyrën e fushës së studimit, përcaktojnë studentët që diplomohen nëpërmjet tezës së diplomës. (Evidenca-10-Rregullore Departamentit Neni 26).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe</p>	<p>GVJ nuk konstaton informacion nga departamenti i gjuhëve të huaja për asistencën në kryerje e matjeve, analizave apo testeve të ndryshme për mugesë të nevojës së realizimit të tyre për këtë program studimit.</p>

fushës së studimit.	
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i tezës së provimit të përgjithshëm ose mbrojtjes së diplomës bëhet me notë dhe llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit. Ky vlerësim pasqyrohet në procesverbal dhe i bëhet e ditur studentit, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Studenti që kalon me sukses tezën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar pajiset me diplomën përkatëse (Evidenca-10-Rregullore Departamentit Neni 30- Neni 29 Vlerësimi i tezës së diplomës; Evidenca-7-Rregullore FE 2019, Neni 76))</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ verifikoi se kryesekretarja regjistron në regjistrin e diplomave dhe të suplementeve të notave, diplomat e fituara dhe suplementet e protokolluara, përpara se të tërhiqen. Gjithashtu u konstatua se studentët të cilët nuk dorëzojnë kërkesën e diplomimit brenda vitit akademik, me kërkesë të tyre u lëshohet vërtetimi i notave, ku shënohen të gjitha lëndët me kreditet e fituara e notat përkatëse, si dhe nota mesatare e ponderuar. Kërkesën e diplomimit studentët mund ta dorëzojnë në sezonin e ardhshëm të diplomimit. GVJ evidenton se tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës ose mund të kryhet nga një person i autorizuar me prokurë të posaçme në mungesë të studentit (Evidenca-10-Rregullore Departamentit-Neni 27 Organizimi dhe zhvillimi i diplomimit). GVJ konstaton se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018.Neni, 76).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Dokumentacioni i procesit mësimor përfshin ruajtjen e të dhënave në tre regjistra kryesorë: regjistri themeltar, ku ruhen bazat e të dhënave të studentëve dhe çdo student pajiset me numër të vecantë matrikulimi;2.regjistri i arritjeve akademike që përmban rezultatet e studentëve; 3. regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018, Neni 92)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin e studimit në Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, kryhet me provim të përgjithshëm ose punim diplome, procedurë e cila është parashikuar në rregullore të posaçme, “Rregullore e Diplomimit”. Studenti duhet të grumbullojë 180 kredite (ECTS) dhe 6 kredite (ECTS) për të përmbushur detyrimin përmbyllës të diplomimit. Departamenti i Gjuhëve të Huaja me fillimin e semestrit të dytë të studimit përcakton kriteret dhe studentët që diplomohen nëpërmjet tezës së diplomës, ku</i></p>

	<i>sipas rregullores së programit të studimit është përvcaktuar pragu i notës mesatare (8) për mbrojtjen me punim diplome. GVJ rekomandon që ky kriter të bëhet publik në çdo rregullore që prek veprimtarinë e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar RVB dhe dokumentacionit ne DVV nga GVJ konstatohet se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe i përgjigjet nevojave për realizimin e kurrikulës. Stafi akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit për mbulimin e lëndëve.(Evidenca nr.23 – Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit, pika 2.2.1; Evidenca nr. 62 – Stafi akademik për programin e studimit). Siç është vënë në dukje në kriterin 4 të standardit III.1 stafi akademik (PAE) i angazhuar në programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, është në total (14) dhe përbëhet nga (2) Profesorë të Asociuar; (8) Doktorë të Shkencave; (3) MSc dhe një (1) docent; ndërsa stafi akademik me kontratë (PAK) është në total (8) dhe përbëhet nga një (1) staf akademik me graden 'Doktor i Shkencave' dhe (7) MSc. (Dok. Shtesë – Evidencë 5, Tabelat 6.1-6.3). Fusha akademiko-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në program është në përputhje me natyrën dhe specifikat e lëndëve dhe moduleve që mbulojnë. Nga shqyrtimi i CV-ve duket se orientimi i studimeve të tyre pasuniversitare dhe interesave akademike kërkimore përkon me ekspertizën në fushat respektive në kurrikul (Evidencat CV të stafit akademik.)
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për	Bazuar në dokumentacionin përkatës në DVV GVJ konstaton se ngarkesa e stafit reflekton balancim në njësi dhe përkon me kuadrin ligjor në fuqi. (Evidencë nr.43-Ngarkesa mesimore e Personelit

<p>programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Akademik te Angazhuar ne programin e studimit). Nga takimi që GVJ pati me personelin akademik u konstatua që ngarkesa e orëve mësimore për lektor ishte brenda normës të paracaktuar sipas kategorive respektive të kualifikimit të personelit. (Vizita në insitucion – takim me stafin akademik).Pavarësisht këtyre konstatimeve GVJ vëren se raporti PAE/PAK sipas viteve akademike dhe në përqindje është: 2020-2021 13 PAE/ 5 PAK (72% e ngarkesës mbulohet nga PAE) 2021-2022 13 PAE/5 PAK (72% e ngarkesës mbulohet nga PAE) 2022-2023 14 PAE/8 PAK (63% e ngarkesës mbulohet nga PAE) (Ref.Dok. Shtesë – Evidencë 5, Tabelat 6.1-6.3). Si edhe vërehet për vitin akademik 2022-2023, PAE mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore, pavarësisht se diferenca nga standarti është e vogël (7%). (Ref. VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre, pika 2b/ii) Standardet për personelin akademik të IAL-së).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka nënshkruar kontrata punësimi me institucionin (ku përfshihen edhe mbulimet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore), të cilat ruhen në dosjet personale të tyre, për të cilat është përgjegjëse zyra e burimeve njerëzore. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësues të kësaj zyre, nga shqyrtimi i tri dosjeve rastësore të personelit të përfshirë në programin e studimit u konstatua, që në secilën dosje ndodhej kontrata e punësimit (DVV; Vizita në institucion – Takim me zyrën e burimeve njerëzore.)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur ne DVV konstatohet që procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit për përzgjedhjen e personelit mbështeten në kriteret të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara nga Departamenti dhe të shpallura në kohë. Për vlerësimin e kandidatëve krijohet komisioni ad hoc prej 5 anëtarësh, 3 përfaqësues të njësisë bazë, 1 përfaqësues i propozuar nga Dekani dhe një tjetër përfaqësues i propozuar nga Rektori. Kërkesa për staf hartohet nga Departamenti e më pas i kalon hierarkisë institucionale, Dekanit e më pas Rektorit. Njësia bazë përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës, ia përcjell ato njësisë kryesore, e cila i dërgon më pas në Rektorat për miratim. Njoftimi për punësim të personelit akademik shpallet nga njësia kryesore në formë të shkruar dhe elektronike dhe në faqen zyrtare Web, njoftim në të cilin përfshihen procedurat e aplikimit, kushtet që duhet të përmbushin kandidatët dhe kriteret e</p>

	<p>vlerësimit. (Evidenca nr.2 – Stauti UAMD, nenet 45,46; Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, nenet 103,104; Evidenca nr.7 - Rregullore FE, nenet 22,26; Evidenca nr.10 –Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, nenet 31-34) Procedurën administrative të rekrutimit të personelit akademik e ndjek Sektori i Burimeve Njerëzore. (Evidenca nr 25 – Rregullore Drejtoria e burimeve njerëzore dhe juridike; Evidenca nr.122 – Procedurë rekrutimi.)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në shyrtrimin e DVV dhe në mënyrë specifike të planit mësimor GVJ konstaton se programi i studimit “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” nuk e ka të parashikuar në kurrikulën e tij zhvillimin e orëve laboratorike. Si rrjedhojë ky kriter nuk mund të gjejë zbatim. (Evidenca nr.36 – Plani mësimor për programin e studimit.)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ konstaton se në rregulloren e Fakultetit të Edukimit , të Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe të programit të studimit është përcaktuar që mbledhja, ruajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit si edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ, është përgjegjësi dhe kompetencë e Sektorit të Burimeve Njerëzore. (Evidenca nr. 7 - Rregullore FE; Evidenca nr.10 –Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja; Evidenca Rregullore e programit të studimit, Evidenca nr 25 – Rregullore Drejtoria e burimeve njerëzore dhe juridike; Vizita në institucion)</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e Sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ konstaton se kjo zyrë dispononte të dhëna të plota mbi anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të tri dosjeve rastësore të personelit të përfshirë në programin e studimit u konstatua, që dosjet ishin të plota me dokumentacionin e duhur si : ID, CV, kontratë mes palëve, çertifikata të titujve dhe gradave shkencore, dëshmi të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, dëshmi gjuhësh të huaja etj.(Referuar vizitës në insitucion)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në</p>	<p>Referuar RVB dhe DVV konstatohet nga GVJ që programi i studimit ka parashikuar në kurrikulën e tij kryerjen e praktikës profesionale, për realizimin e së cilës UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës.(Evidenca nr.49 – Marrëveshjet e bashkëpunimit; Evidenca nr 63. – Marrëveshje</p>

<p>dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>bashkëpunimi me DAR) Për këtë është ngarkuar dhe vënë në dispozicion personel i kualifikuar për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale. Kjo detyrë e mbikëqyrjes dhe udhëheqjes së praktikave është ndarë mes pedagogëve të specializuar në këtë drejtim. (Evidenca nr. 117 – Ndarja e praktikës në department). Për realizimin e punimit të diplomës studentëve u është në dispozicion një manual me gjithë informacionet e nevojshme. Në ndihmë u vijnë edhe anëtarë të stafit akademik me udhëzimet dhe mbështetjen e tyre. (Evidenca nr.121 – Manual për punimin e diplomës)</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur për shqyrtim GVJ del në konstatimin që gjatë kryerjes së praktikës profesionale studenti është nën mbikëqyrjen e pedagogut të ngarkuar me këtë detyrë, i cili ndjek zhvillimin dhe frekuentimin e praktikës mësimore, (Evidenca nr. 117 – Ndarja e praktikës në department) si edhe nën mbikëqyrjen e personelit përkatës në institucionin pritës. Në përfundim të praktikës profesionale studenti dorëzon një raport të praktikës dhe vlerësohet nga pedagogu dhe nga personeli pritës. (Evidenca nr.116 – Rregullore e praktikës; Evidenca nr. 118 – Dosja e plotë e praktikave për programin e studimit; Evidenca nr.119 – Procesverbal Praktikë mësimore.)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Stafi akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit për mbulimin e lëndëve, ngarkesa mësimore që ata mbulojnë është brenda normës të caktuar. Rekrutimi i tyre kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga institucioni, me kritere të përgjithshme dhe specifike. Të gjitha të dhënat e stafit ruhen nga zyra e burimeve njerëzore. Për vitin akademik 2022-2023, raporti i stafit mësimdhënës në programin e studimit paraqitet 14 PAE/8 PAK, ku 63% e ngarkesës mbulohet nga PAE, pra konstatohet se PAE mbulon më pak se 70% të ngarkesës mësimore të parashikuar sipas udhëzimeve ligjore në fuqi, pavarësisht se diferenca nga standarti është e vogël (7%). Ndërsa për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 PAE mbulon 72% të ngarkesës mësimore në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në vend.</i> <i>Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera vë në dispozicion personelin e duhur e të kualifikuar për udhëheqjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin

praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV dhe në vizitën e kryer në institucion, konstatohet se FE/DGJGJ siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në përputhje me specifikën e programit të studimit dhe në varësi të numrit të studentëve. Njësia kryesore dhe ajo bazë shfrytëzojnë 23 salla leksionesh dhe seminaresh, 2 për aktivitete promovuese, 2 laboratorë informatike, 1 sallë për bibliotekën etj.(DVV; Evidenca nr.71 – Infrastruktura në funksion të programit të studimit; Evidenca tabela përmbledhëse; Vizita në institucion.)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (krahas informacionit të paraqitur në DVV) GVJ konstatoi se pjesa më e madhe e sallave ku zhvillohen leksionet, seminarët, biblioteka ishin të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për të siguruar mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore. Në disa auditorë gjendeshin edhe tabela interaktive. Lidhja e internetit ishte në të gjitha ambientet. (Evidenca nr.71 – Infrastruktura në funksion të programit të studimit; Vizita në institucion; Evidenca tabela përmbledhëse) Do të rekomandonim shtimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit , në mënyrë që të pajisen të gjitha sallat.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelierët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Siç u përmend në kriterin e mësipërm, pjesa dominuese e auditorëve ishte e pajisur me aparaturat dhe mjete të nevojshme elektronike, në funksion të realizimit dhe përmbushjes së objektivave të programit të studimit. (Evidenca nr.71 – Infrastruktura në funksion të programit të studimit; Vizita në institucion; Evidenca tabela përmbledhëse) Pajisja totale e tyre duhet të jetë në fokus, për të ndihmuar në realizimin e objektivave.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni / DGJGJ ka në funksion një laborator të teknologjisë së informacionit, i cili i vjen në ndihmë procesit mësimor, duke u vënë në përdorim për realizimin e aftësive të të folurit dhe të dëgjuarit. (Evidenca nr.71 – Infrastruktura në funksion të programit të studimit; Vizita në institucion)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, të pajisura me mjete elektronike</i></p>

	<i>dhe të teknologjisë së informacionit dhe me një laborator, i cili i vjen në ndihmë procesit mësimor. GVJ rekomandon shtimin e pajisjeve elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit në DVV GVJ konstaton se literatura bazë dhe ndihmëse për programin e studimit u është vënë në dispozicion studentëve në formë fizike dhe digjitale (Evidenca nr.85 - Biblioteka Online-Të dhëna mbi materialet e disponueshme ; Evidenca nr.87 - Të dhëna për bibliotekën; Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike), gjë që i ndihmon ata në marrjen e dijeve dhe njohurive, por duhen përpjekje të mëtejshme për pasurimin e bibliotekës me tituj si edhe me literaturë të viteve të fundit për të gjitha lëndët e programit të studimit. (Vizita në institucion: Inspektim i bibliotekës fizike) Jo të gjitha lëndët mbulohen me literaturë aktuale, konstatim ky i bërë pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve, kështu që lind domosdoshmëria për rifreskim, përditësim dhe pasurim të bibliotekës. (Evidencat: Syllabuse të lëndve të programit të studimit.)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit kujdeset që literatura e secilës lëndë të ruhet në departament, pasi të jetë miratuar në fillim të vitit akademik me ndryshimet dhe përditësimet e mundshme dhe të jetë pasqyruar edhe në syllabuset e lëndëve nga pedagogët përkatës. Këtë konstatim GVJ e bëri pas bisedës me drejtuesen e departamentit gjatë vizitës në institucion. (Vizita në institucion, takim me drejtuesen e departamentit)
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstaton se biblioteka fizike dhe ajo digjitale është në dispozicion të çdo studenti të programit të studimit dhe u garanton atyre mundësinë e shfrytëzimit të saj në mënyrë të barabartë. (Evidenca nr. 83 – Rregullore e bibliotekës; Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike dhe asaj online) Për përdorimin e bibliotekës digjitale studentëve u është në dispozicion manuali i përdorimit të saj. (Evidenca nr.84 – Biblioteka online Manual përdorimi)
Kriteri 4. Biblioteka duhet të	GVJ rithekson faktin e përmendur edhe në kriterin 1 të këtij standardi,

<p>jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>që duhet të vazhdojë pasurimi i fondit fizik të bibliotekës me literaturë të viteve të fundit për të gjitha lëndët / modulet dhe veprimtaritë mësimore të programit të studimit.</p> <p>Për t'u vlerësuar është mundësia e ofruar për shfletimin elektronik të katalogut të literaturës pranë kompjuterave të sallës, duke ua lehtësuar kërkimin studentëve, apo edhe pedagogëve. (Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike.)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka krijuar kushtet që të gjithë studentët të shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë bibliotekën online, për të siguruar literaturën e nevojshme për fushën e programit të studimit. Ky shërbim ofrohet pa pagesë jo vetëm për studentët, por edhe për personelin. (Evidenca nr. 83 – Rregullore e bibliotekës; Evidenca nr.84 – Biblioteka online Manual përdorimi)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se biblioteka ofron mundësinë e shfrytëzimit të saj pa kufizim nga të gjithë studentët, me një mjedis të përshtatshëm për të punuar, e pajisur me program kompjuterik, i cili mundëson navigimin në katalogun elektronik dhe u vjen në ndihmë të gjithë studentëve. (Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike.)</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstaton se kapaciteti i bibliotekës i përgjigjet numrit të studentëve dhe i plotëson nevojat e tyre në mjedise dhe pajisje. (Vizita në institucion, inspektim i bibliotekës fizike.) Oraret e shërbimit të vëna në dispozicion përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, pasi biblioteka është e hapur edhe gjatë fundjavës. (Evidenca nr.83 - Rregullore e bibliotekës; Evidenca nr.86 – Evidenca që biblioteka funksionon edhe në fundjavë.)</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave</p>	<p>Biblioteka dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja paraqesin herë pas here kërkesa për pasurim të literaturës, blerje librash e materialesh, si edhe raportojnë mbi cilësinë e fondit të bibliotekës si fizike edhe asaj online. Këtë konstatim e bëjmë pas bisedës me stafin akademik të programit të studimit dhe bisedës me drejtuesen e departamentit. Nga ana e tyre tregohet interes për pasurim të fondit të bibliotekës. (Vizita në institucion, takimi me drejtuesen e departamentit, takimi me stafin akademik.)</p>

<p>të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Literatura bazë dhe ndihmëse për programin e studimit u është vënë në dispozicion studentëve në formë fizike dhe digjitale dhe u garanton atyre mundësinë e shfrytëzimit të saj në mënyrë të barabartë në një mjedis të përshtatshëm për të punuar, e pajisur me program kompjuterik, i cili mundëson navigimin në katalogun elektronik, me orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre duke qenë se biblioteka është e hapur edhe gjatë fundjavës.</i></p> <p><i>Për t'u përmirësuar mbetet pasurimi i bibliotekës fizike, sidomos me literaturë të viteve të fundit, me tituj për të gjitha lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit të studimit.</i></p> <p><i>Për shkak të kësaj mangësie kriteri vlerësohet si i përmbushur kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni disponon sistemin e menaxhimit Pitagora, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin mbi studentët nga regjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre. (Evidenca nr.93 – Komunikim për përdorimin e sistemit PITAGORA)</p> <p>Informacionin mbi studentët dhe veprimtarinë e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin institucioni e ruan edhe në formë të shkruar, të ruajtur në sekretarinë mësimore.(Evidenca nr.92 – Rregullore e sekretarisë; Vizita në institucion : vizita në sekretari.)</p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në bazë të informacionit të marrë nga shqyrtimi i DVV dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se sistemi i brendshëm i menaxhimit që disponon institucioni administron informacionin dhe dokumentacionin e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Në të pasqyrohet plani mësimor, orari, vlerësimet e provimeve, oraret e konsultimeve etj. (DVV; Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit në DVV GVJ konstatoi se i gjithë personeli akademik e administrativ dhe të gjithë studentët e programit të studimit kanë akses në informacione e dokumentacion, të siguruar nga sistemi i menaxhimit. (DVV; Vizita në institucion: takim me stafin, takim në sekretarinë mësimore; Evidencë-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.)</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga biseda me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit Gvj konstaton se përmes sistemit të menaxhimit personeli akademik dhe studentët komunikojnë dhe shkëmbejnë informacione të ndryshme mbi lëndët , detyra kursi, mbi vlerësimin në provim etj. . (DVV; Vizita në institucion: takim me stafin, takim me studentët; Evidencë-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.)</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ konstaton se aktiviteti akademik e administrativ, procesi mësimor, vlerësimi i studentëve, respektimi i orarit etj. janë në monitorim përmes sistemit të menaxhimit, duke mundësuar të dhëna në kohë reale për autoritetet drejtuese. (Evidencë nr.90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstaton se të gjitha informacionet mbi programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të UAMD dhe në rrjetet sociale zyrtare të FE, DGJGJ. (Evidencë nr.99-Të dhëna nga Website-i i UAMD-së: http://www.uamd.edu.al/; Evidencë nr.100 - Thirrje të publikuara në faqen zyrtare të UAMD; Evidenca nr.101 -Të dhëna nga Facebook-u i FE-së) Informacionet e publikuara në faqen zyrtare të internetit janë në gjuhën shqipe dhe atë angleze. http://www.uamd.edu.al/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni disponon sistemin e menaxhimit Pitagora, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin mbi studentët nga regjistrimi në programin e studimit deri në diplomimin e tyre. Ky sistem administron edhe Informacionin dhe dokumentacionin e personelit akademik, duke</i></p>

	pasqyruar planin mësimor, orarin, vlerësimet e provimeve, oraret e konsultimeve etj. I gjithë personeli akademik e administrativ dhe të gjithë studentët e programit të studimit kanë akses në informacione e dokumentacion, të siguruara nga sistemi i menaxhimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Pas shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion u konstatua që UAMD harton në mënyrë periodike një raport financiar të institucionit, në të cilin pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. (Evidenca nr.102 – Miratimi i raportit të aktivitetit vjetor të UAMD-së; Evidenca nr.103 - Raporti i veprimtarisë audituese) Gjithashtu njësia bazë harton planin buxhetor afatmesëm dhe ia dërgon atë dekanatit. Ky plan përfshin përllogaritjen dhe parashikimin e të ardhura për një cikël të plotë studimi, nga regjistrimi në universitet deri në diplomimin e studentëve. (Evidenca Projekt buxheti dhe plani financiar 2024-2026)
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të	Referuar dokumentacionit përkatës GVJ konstaton se DGJGJ harton një plan buxhetor, në të cilin përfshihen përllogaritje e të ardhurave të pritshme preventive për realizim workshop-i, përllogaritje e shpenzimeve për kërkimin shkencor siç është preventivi për realizim konference studentore dhe preventivi për realizim konference ndërkombëtare shkencore, financimi i burimeve njerëzore, shërbime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, etj. (Evidenca Projekt buxheti dhe plani financiar 2024-2026).

studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas RVB UAMD i nënshtrohet auditit të brendshëm dhe të jashtëm financiar. Në rregulloren UAMD, në nenin 91 të saj përcaktohet që organi që mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e UAMD në fushën administrative, financiare dhe ekonomike është Bordi i Administrimit (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, neni 91), i cili ushtron funksionet e tij mbi bazën e ligjit për arsimin e lartë, të statutit dhe rregullores së UAMD dhe rregullores së tij të brendshme. (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, neni 92) Për auditimin e brendshëm është ngritur Njësia e Auditimit të Brendshëm, e cila varet nga Bordi i Administrimit. (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, neni 95) Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion për shqyrtim GVJ konstaton se institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. (Evidenca nr.103 - Raporti i veprimtarisë audituese). Në evidencën nr.103 të DVV paraqitet raporti financiar për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara gjatë vitit akademik 2021-2022, ku përfshihen të dhëna mbi shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për kërkimin shkencor, bursa etj., si edhe të dhëna mbi të ardhurat e arkëtuara.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e marrë nëpërmjet RVB, DVV dhe faqes zyrtare të UAMD (https://uamd.edu.al/informacione-mbi-buxhetin/) GVJ konstaton se institucioni publikon të dhënat mbi realizimin e buxhetit të miratuar, duke bërë të mundur informimin e të gjitha palëve të interesuara. Në rregulloren e UAMD dhe rregulloren FE është parashikuar zgjedhja e administratorit të njësisë bazë, i cili midis detyrave të tij ka edhe zbatimin e vendimeve të administratorit të njësisë kryesore për mënyrën e ndarjes së të ardhurave të realizuara. (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, neni 99; Evidenca nr.7 – Rregullore FE)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e raporteve financiare të vëna në dispozicion në DVV GVJ konstaton që institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe zotëron kapacitetet e mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare. (Evidenca nr.102 - Miratimi i raportit të aktivitetit vjetor të UAMD-së; Evidenca nr.103 - Raporti i veprimtarisë audituese; Evidenca Projekt buxheti dhe plani financiar 2024-2026; https://uamd.edu.al/informacione-mbi-buxhetin/) Në nenin 96 të statutit të UAMD përcaktohet që burimet e financimit të UAMD janë buxheti i shtetit, fondet e siguruar nga tarifat e regjistrimit, veprimtari kërkimore – shkencore, projekte, shërbime që ofron institucioni etj. (Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, neni 96)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>UAMD harton në mënyrë periodike një raport financiar të institucionit, një plan buxhetor, në të cilin përfshihen: financimi i burimeve njerëzore, shërbime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzime për laboratorë, fonde për aktivitete shkencore etj. Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare, ku burimet e financimit janë buxheti i shtetit, fondet e siguruara nga tarifat e regjistrimit, shërbime që ofron institucioni. UAMD i nënshtrohet auditit të brendshëm dhe të jashtëm financiar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, në rregulloren e UAMD-së, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e Departamentit dhe të programit të studimit GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura, që mbulojnë një cikël të plotë akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. UAMD realizon pranime të studentëve në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin e Senatit dhe me akte të tjera rregullatore të tij. (Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, kreu VI, neni 57, 62; Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, kreu III, neni 44; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, Kreu V, neni 45; Evidenca Rregullore e programit të studimit.) Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese si edhe përmes fushatave promovuese.(https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit) GVJ konstaton se gjatë gjithë ciklit akademik dhe deri në diplomimin e tyre studentët mbështeten me politika dhe procedura, të cilat u krijojnë atyre kushte të barabarta për të studiuar, për te qenë të përfaqësuar në organe të ndryshme, për t’u informuar, për t’u

	vlerësuar, për infrastrukturën në mbështetje të programit të studimit, për mobilitete etj. (Dosja e plotë e vetëvlerësimit)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Këto procedura dhe politika mbështeten në Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e UAMD-së, në Rregulloren e Fakultetit dhe të programit të studimit, si edhe në udhëzimet e MAS. (Evidenca nr.2-Stauti UAMD, Kreu VI; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, nenet 45,58; Evidenca Rregullore e programit të studimit)
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konstaton se përpara çdo viti akademik institucioni, përkatësisht FE dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja përcakton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për ciklin e parë të studimeve. (Evidenca nr.54 – Vendim senati për kriteret e pranimit të studentëve) Përcaktimi i kuotave dhe kriterëve bëhet duke iu referuar Ligjit Arsimit të Lartë, udhëzimeve të MAS si dhe VKM-ve përkatëse. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Ato parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve nga trojet, kuota për program të dytë studimi, për transferim studimesh, për kandidatë me statusin e jetimit, për persona me aftësi të kufizuar, si edhe kandidatë të komunitetit rom dhe ballkano- egjiptian. (Evidenca nr.55 – Vendim senati për kuotat; Evidenca nr.57 – Shpërndarja e kuotave të pranimit të studentëve)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Të gjitha informacionet mbi kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve gjenden të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe janë të aksesueshme nga publiku. GVJ e konstaton këtë fakt në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, të vizitës në institucion dhe inspektimit të faqes zyrtare të UAMD. (DVV; Faqja web https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit) Gjithashtu institucioni ka aktiv sistemin e menaxhimit të informacionit Pitagora, me anë të të cilit studentët mund të marrin lehtësisht informacione mbi përparimin gjatë studimeve, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. (https://uamd.edu.al/pitagora/)
Kriteri 5. Përpara fillimit të	Nga GVJ konstatohet se, në lidhje me kërkesat dhe kriteret e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, publiku dhe të interesuarit marrin informacione dhe udhëzime nga institucioni përmes faqes së tij zyrtare si edhe përmes fushatave promovuese, nëpërmjet aktiviteteve informuese me nxënës maturantë, përmes organizimit të ditëve të hapura, mediave lokale ose fletëpalosjeve.(Evidenca nr. 100 – Thirrje të publikuara në faqen zyrtare të UAMD; Evidenca nr.107 – Broshura para promovimit; Evidenca nr.109 – Informacione mbi programin e studimit në facebook)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ evidenton se përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë. Këto kriteret janë të barabarta për të gjithë, edhe për kandidatët me aftësi të veçanta, me statusin e jetimit, të komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian, për të cilët parashikohen kuota të veçanta. (Evidenca nr.54 – Vendim senati për kriteret e pranimit të studentëve; Evidenca nr.55 – Vendim senati për kuotat; Evidenca nr.57 – Shpërndarja e kuotave të pranimit të studentëve) Në rregulloren e programit të studimit është theksuar që pranimi i studentëve bëhet sipas udhëzimeve të MAS. (Evidenca – Rregullore e programit të studimit, neni 23)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për përzgjedhjen e kandidatëve për student që vijnë nga shtete të tjera në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar që ata duhet të përmbushin të njëjtat kriteret si studentët nga Shqipëria. (Evidenca – Rregullore e programit të studimit, neni 23) Në kuotat e pranimit të studentëve janë parashikuar edhe kuota për kandidatë nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. (Evidenca nr.57 – Shpërndarja e kuotave të pranimit të studentëve)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Konstatohet se për studentët nga shtresat në nevojë institucioni harton politika të mbështetjes financiare përmes bursave të studimit. (Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, neni 99)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura, që mbulojnë një cikël të plotë akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Përcaktimi i kuotave dhe kriterëve të pranimit të studentëve bëhet duke iu referuar Ligjit Arsimit të Lartë, udhëzimeve të MAS si dhe VKM-ve përkatëse. Informacionet dhe udhëzimet e nevojshme në</i></p>

	<p><i>lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit publiku dhe të interesuarit i marrin përmes faqes zyrtare të institucionit, fushatave promovuese, aktiviteteve informuese, organizimit të ditëve të hapura, mediave lokale ose fletëpalosjeve.</i></p> <p><i>Në shpërndarjen e kuotave për kandidatët për studentë janë parashikuar edhe kuota për kandidatët nga trojet, për program të dytë studimi, për transferim studimesh, për kandidatë me statusin e jetimit, për persona me aftësi të kufizuar, si edhe kandidatë të komunitetit rom dhe ballkano- egjiptian. Për studentët nga shtresat në nevojë institucioni harton politika të mbështetjes financiare.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se përveç informimit nga faqja zyrtare e internetit e FE dhe DGJH, e cila është e aksesueshme për të gjithë të interesuarit, informacion i plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentit vihet në dispozicion përmes sekretarisë mësimore, pedagogut të lëndës, adresave të e-mailit dhe stendës së publikimeve të DGJH. (Evidenca nr.7 – Rregullore FE, kreu VII; Faqja web www.uamd.edu.al ; Evidenca nr.92 – Rregullore e sekretarisë; Vizita në institucion:takim me studentët, me stafin akademik, vizitë në sekretari)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në DVV dhe bisedën me studentët gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se studentët marrin informacion nga institucioni për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve. Ata marrin informacion mbi programin e studimit, mbi mundësinë dhe njohjen e krediteve në rast transferimi të studimeve, për regjistrim në program të dytë apo ripranim, si edhe në rastet e mobilitetit të studentëve përmes programit Erasmus. Informacioni mund të merret në department, ose në sekretarinë mësimore. (Vizita në institucion :takim me studentët, takim me drejtuesen e departamentit, takim me stafin akademik.)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Kriterert dhe procedurat e vlerësimit të dijeve janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD(Evidenca nr. 4- Rregullore UAMD, neni 68,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>69) GVJ konstaton se studentët vihen në dijeni të kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre që në orën e parë të zhvillimit të lëndës, ku pedagogu përkatës e njeh me programin e lëndës dhe me formën dhe procedurat e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit. Gjithashtu studentët informohen mbi këto kriterë dhe procedura përmes takimeve në departament, faqes së web-it të UAMD si edhe nga sekretaria mësimore. Ky konstatim i GVJ bëhet bazuar edhe në bisedat e zhvilluara gjatë takimeve në institucion me studentët, drejtuesen e departamentit dhe stafin akademik) (Vizita në institucion)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Këto procedura parashikohen në Rregulloren e UAMD, të FE, të DGJH dhe të programit të studimit. (Evidenca nr. 4-Rregullore UAMD; Evidenca nr.7 – Rregullore FE; Evidenca nr 10 – Rregullore e departamentit; Evidenca Rregullore e programit të studimit) DGJH vë në dispozicion të studentëve manualin për punimin e tezës së diplomës, i cili përmban gjithë udhëzimet e nevojshme mbi punimin e tezës së diplomës si edhe kriteret e vlerësimit të saj. (Evidenca nr.121- Manual për punimin e diplomës; Evidenca nr.32 – Formulari i kërkesës për tezën e diplomës dhe vlerësimi)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni angazhohet në informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD (www.uamd.edu.al), fletëpalosjeve të ndryshme (Evidenca nr.107 – Broshura para promovimit), javës së orientimit (Evidenca nr.29 – Java e orientimit dhe guida e studentit) dhe zyrës së sekretarisë së Fakultetit, siç është edhe e parashikuar në rregulloren e sekretarisë. (Evidenca nr.92 – Rregullore e sekretarisë; Vizita në institucion – takim në sekretarinë mësimore.)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Faqja zyrtare e fakultetit dhe e departamentit, sekretaria mësimore dhe pedagogët e lëndëve vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, mbi procedurat e njohjeve të kualifikimeve, mbi vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre, mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tcl:+355 (04) 222-43123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD(Faqja web www.uamd.edu.al), ku janë të publikuara struktura dhe organizimi i programit të studimit, kohëzgjatja e studimeve, diploma që do të marrin etj. Organizimi i studimeve është i pasqyruar me detaje në rregulloren e UAMD, të FE, të DGJH dhe të programit të studimit (Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD,kreu III; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, kreu V; Evidenca nr.10 – Rregullore DGJH, seksioni IV) Gjithashtu studentët informohen edhe përmes takimeve me stafin akademik, ose në sekretarinë mësimore të fakultetit, në zbatim edhe të rregullores së saj. (Evidenca nr.92 – Rregullore e sekretarisë; Vizita në institucion – takim në sekretarinë mësimore, takim me stafin akademik, takim me studentët.) Këto evidencime vijnë pas shqyrtimit nga ana e GVJ e DVV dhe vizitës së kryer në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve u është vënë në dispozicion i gjithë informacioni mbi lëndët që zhvillohen gjatë programit të studimit si edhe mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Këto informacione studenti i merr nga pedagogët e lëndëve, ose dhe nga faqja web e institucionit. (Faqja web www.uamd.edu.al ; Vizita në institucion – takim me stafin akademik, takim me studentët.)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit si edhe i orienton drejt tregut të punës nëpërmjet zyrës së komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, e cila organizon takime me studentët, i trajnon ata, i udhëzon dhe i informon drejtperdrejt ose përmes faqes së saj online mbi mundësi të ndryshme punësimi.(Evidenca nr.26- Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca nr.30- Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni; Evidenca nr.31- Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Takimi informues me stafin akademik, faqja zyrtare web e UAMD, sekretaria mësimore, stendat informuese vendosin në dispozicion të studentëve informacion të përditësuar mbi procesin mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Këto fakte u pohuan gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët aktualë të programit të studimit. (Vizita në institucion) Gjithashtu GVJ konstaton se përmes sistemit të menaxhimit të informacionit studentët informohen gjerësisht mbi organizimin e procesit mësimor shërbime të tjera. (Evidenca nr.90 - Rregullore e sektorit të</p>

	teknologjisë dhe informacionit; Evidenca nr. 96 - Programi i transparencës UAMD)			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni mbi programin e studimit që u ofrohet studentëve nga sistemi i menaxhimit të informacionit, është lehtësisht i arritshëm prej tyre, madje edhe në distancë. (Evidenca nr. 96 - Programi i transparencës UAMD; Vizita në institucion – Takim me studentët e programit të studimit.) Sistemi mundëson lehtësi në komunikimin me stafin akademik si edhe në marrjen e çdo informacioni tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor.			
Konkluzione	<i>Nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD, përmes takimeve me stafin akademik, ose në sekretarinë mësimore të fakultetit studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, mbi mundësitë e punësimit, mbi organizimin e procesit mësimor dhe mbi shërbimet në funksion të realizimit të tij. Institucioni i orienton ata drejt tregut të punës nëpërmjet zyrës së komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</i> <i>Kriteret e standardit përmbushen të gjitha, si rrjedhojë i gjithë standardi vlerësohet i përmbushur plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Këto statistika gjenden në regjistrat përkatës në zyrën e sekretarisë mësimore, në zbatim të rregullore së programit të studimit dhe asaj të fakultetit. (Evidenca nr. 92– Rregullore e sekretarisë; Evidenca nr.7 – Rregullore FE; Evidenca Rregullore e programit të studimit; Vizita në sekretarinë mësimore.)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i	Përmes zyrës së sekretarisë mësimore institucioni disponon të gjitha statistikat e nevojshme mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, të studentëve të diplomuar, të transferuar apo të tërhequr nga programi i studimit. (Evidenca nr. 92– Rregullore e sekretarisë; Vizita në sekretarinë mësimore.) Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ-së iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Viti akademik 2020-2021 35 studentë Viti akademik 2021-2022

studimeve.	35 studentë Viti akademik 2022-2023 24 studentë
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Referuar DVV GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Gjithashtu gjatë vizitës në institucion u konstatua se sekretaria mësimore ruan dhe menaxhon të dhënat e studentëve në regjistrat përkatës dhe në database të sekretarisë. Këto të dhëna janë të sigurt dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar, bazuar në statutin e UAMD-së dhe në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave vetjake. (Evidencë-97-Ligji nr.9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.)
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni i nënshtrohet kontrollit periodik përmes njësisë së Auditit të Brendshëm, e cila ushtron veprimtarinë e saj për të vlerësuar zbatimin dhe respektimin e procedurave të menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të të gjitha njësive.(Evidenca nr.103 – Raport i veprimtarisë audituese; Evidenca nr.17 – Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurisë së cilësisë; Evidenca nr.19 – Politika dhe strategjia e sigurimit të cilësisë së brendshme.)
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstaton se analiza e ecurisë së procesit mësimor, e profilit të studentëve, e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre kryhet rregullisht nga njësia bazë dhe paraqitet në analizën mësimore vjetore. Për shkallën e punësimit të studentëve dhe drejtimin e duhur të tyre njësia bazë bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës.(Evidenca Anketë dhe raporti i Alumni-t; Evidenca nr.26 – Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca nr.27 – Shoqata Alumni; Evidenca nr. 30 – Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.)
Konkluzione	<i>Institucioni disponon dhe mban statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, për numrin e studentëve të diplomuar, për tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit . Këto të dhëna menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurt e konfidenciale, por edhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Profili dhe cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, si dhe shkalla e cilësisë së punësimit të tyre bëhen objekt analize, e shoqëruar me masat e</i>

	<i>duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga GVJ evidentohet se në zbatim të ligjit nr 80/2015 , të Statutit të UAMD-së dhe sipas Rregullores së UAMD-së studentët përfshihen dhe angazhohen përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, si në këshillin studentor, senatin akademik, bordin e administrimit, në komisionet e përhershme të UAMD-së, komisionet të ndryshme në nivel fakulteti ose departamenti etj. .(Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, nenet 121,122; Evidenca nr.7 – Rregullore FE, nenet 98,99; Evidenca nr.60 – Ligji i Arsimit të Lartë nr.80 dt.22.07.2015) Ky fakt u pohua nga studentët gjatë bisedës me ta në ditët e vizitës në institucion (Vizita në institucion – bisedë me studentët e programit të studimit.)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në Statutin dhe Rregulloren e universitetit, Rregulloren e sigurimit të cilësisë, rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurisë së cilësisë, në krijimin e GVB është e garantuar përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik, gjë që garanton marrjen dhe përfshirjen e opinionit të tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë dhe në përmirësimin e programit të studimit. .(Evidenca nr.2 – Statuti UAMD, Kreu VII; Evidenca nr.4 – Rregullore UAMD, neni 20; Evidenca nr.17-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurisë së cilësisë; Evidenca nr.21 – Vendim dekanati për krijimin e GVB-ve; Vizita në institucion – takim me GVB) Një rol të rëndësishëm në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit luajnë pyetësorët e studentëve, mbi gjetjet e të cilëve duhet të bëhen analiza dhe të merren masa për përmirësim të mëtejshme. Por GVJ konstaton se rezultatet e pyetësorëve të studentëve i përkasin periudhës 2018-2019 (Evidenca nr.18 – Rezultatet mbi anketimin e studentëve, stafit akademik dhe administrative 2018-2019; Evidenca nr.69 - Rezultatet e vlerësimit të stafit akademik 2018-2019) dhe rekomandon

	përditësimin e tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstaton se FE dhe DGJH garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe merr parasysh sygjërimet dhe shqetësimet e studentëve. Kjo realizohet siç u përmend në kriterin e mësipërm përmes pyetësorëve, por edhe nga takime të studentëve në departament dhe me stafin akademik. (Evidenca nr.18 – Rezultatet mbi anketimin; Evidenca nr.67 – Formulari i vlerësimit të programit të studimit) Gjatë takimit me studentët në ditët e vizitës në institucion u konstatua marrja e masave konkrete dhe të prekshme nga ana e studentëve, të cilët pranuan, që kanë ndjerë përmirësime të dukshme të procesit akademik apo në infrastrukturë pas dhënies së mendimeve të tyre në pyetësorë. (Evidenca nr.18 – Rezultatet mbi anketimin; Vizita në institucion – Takimi me studentët)			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ vë në pah se studentëve u jepet mundësia e dhënies së mendimit mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit, si edhe mundësia e ankimimit të rezultatit rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Kjo e drejtë e tyre është e përcaktuar në rregulloren e UAMD-së dhe në rregulloren e njësisë bazë. (Evidenca nr.4 - Rregullore UAMD, neni 71; Evidenca nr.10 – Rregullore e departamentit, neni 25) Në takimin e zhvilluar me studentët gjatë vizitës në institucion studentët pohuan faktin që në çdo rast ata kanë mundësinë e rishikimit të rezultatit dhe të ankimimit në rast të mosrënies dakort me vlerësimin e dijeve të tyre. (Vizita në institucion – Takimi me studentët)			
Konkluzione	<i>Në zbatim të ligjit nr 80/2015 dhe sipas Rregullores së UAMD-së studentët përfshihen dhe angazhohen përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, si edhe në vlerësimin e procesit akademik. Ky i fundit realizohet përmes pyetësorëve, por edhe nga takime të studentëve në departament dhe me stafin akademik. Studentëve u jepet mundësia e dhënies së mendimit mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit, si edhe mundësia e ankimimit të rezultatit, në rast të mosrënies dakort me vlerësimin e dijeve të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucionit i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konfirmon që institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve siç janë : sekretaria mësimore, drejtuesi i njësisë bazë, zyra e këshillimit të karrierës, faqja zyrtare web e universitetit, fakultetit dhe departamentit të gjuhëve të huaja, si edhe sistemi i menaxhimit të informacionit.(Evidenca nr.92 – Rregullore e sekretarisë; Evidenca nr.10 – Rregullore e departamentit; Evidenca nr.26 – Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Faqja web www.uamd.edu.al ;Evidenca nr.93 – Komunikim për përdorimin e sistemit PITAGORA)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UAMD me vendim rektorati ka organizuar një tutorial / mentorim, i cili konsiston në përkujdesjen e një pedagogu për një grup studentësh përgjatë viteve të studimit, duke i asistuar ata për çështje të ndryshme në lidhje me procesin mësimor, me informim dhe këshillim. (Evidenca nr.59 - Mbi organizimin e tutorialit / mentorimit në UAMD; Evidenca nr.58 – Ndarja e mentorimit në department) Gjithashtu në shërbim të informimit, këshillimit dhe asistencës së studentëve janë edhe njësitë e përmendura në kriterin e mësipërm: sekretaria mësimore, drejtuesi i njësisë bazë, zyra e këshillimit të karrierës, faqja zyrtare web. (Evidenca nr.92 – Rregullore e sekretarisë; Evidenca nr.10 – Rregullore e departamentit; Evidenca nr.26 – Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Faqja web www.uamd.edu.al)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka funksionale dhe u ofron shërbim studentëve përmes zyrës së këshillimit të karrierës, e cila mirëpret këshillon dhe orienton studentët në procese të ndryshme si procesi mësimor, orientimi mbi praktikën profesionale si dhe këshillim karriere në lidhje me qasjen e tyre në tregun e punës.(Evidenca nr.26 – Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca nr.31 – Studentët e trajnuar nga zyra e karrierës; Vizita në institucion – Takim me studentët, vizitë në zyrën e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës krijon një databazë të dhënash mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, mban përgjegjësi për të informuar të gjitha palët e interesuara dhe ua vë në dispozicion autoriteteve drejtuese të institucionit. Ky fakt konstatohet nga GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion për vlerësim.(Evidenca nr.26)</p>

studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	– Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca nr.30 – Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni; Vizita në institucion - vizitë në zyrën e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)			
Konkluzione	<i>Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, të këshillimit dhe orientimit të tyre qëndrojnë sekretaria mësimore, drejtuesi i njësisë bazë, zyra e këshillimit të karrierës, faqja zyrtare web e universitetit, fakultetit dhe departamentit të gjuhëve të huaja, si edhe sistemi i menaxhimit të informacionit. Zyra e këshillimit të karrierës krijon një databazë të dhënash mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

gShkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në referencë me informacionin në RVB dhe dokumentacionin shoqërues në DVV, GVJ konstaton se Statuti i “UAMD”, Neni 77/78 ka parashikuar sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe funksionimin e tij, ku specifikohet se ky sistem mbështetet në garantimin e transparencës, në rritjen e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018). “UAMD” ka hartuar Politikën dhe Strategjinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, e cila udhëzon plotësimin e pyetësorëve prej studentëve për të marrë mendimin e tyre në lidhje me mësimdhënien në të gjitha lëndët; angazhon sekretarinë mësimore, nëpërmjet ndjekjes së vazhdueshme të kryerjes së plotë të orëve mësimore; rekomandon vlerësimin e drejtuesve, nëpërmjet kontrolleve gjatë zhvillimit të orëve të mësimi; zhvillon dhe ndjek në mënyrë interaktive orët mësimore dhe seminarët lidhur me përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (Evidenca-19-

	Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE).
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ evidenton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë krijon një sistem kuadër cilësie nëpërmjet: 1. Proceseve të brendshme – duke vënë në funksionim sisteme që ofrojnë performancë dhe i përgjigjen pyetjeve mbi saktësinë dhe efikasitetin e procedurave të sigurimit të cilësisë. 2.- proceseve të jashtme – duke ju referuar qëllimit, vlerave dhe objektivave të institucionit, të cilat i referohen edhe dokumentave strategjikë kombëtarë dhe studimeve mbi kërkesat e tregut, (Evidenca-17- Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë). GVJ konstaton se personeli akademik, përpos kualifikimeve dhe arritjeve akademike, integron përvojën dhe aftësitë e tij në mësimdhënie dhe inovacion, në kuadër të angazhimeve në projekte ndërkombëtare. Kjo arritje monitorohet nëpërmjet plotësimit të formularit të vetëvlerësimit të personelit akademik (Evidenca-81-Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik, 2019). Pyetësi propozohet nga KPGSC dhe miratohet nga Senati Akademik (Evidenca-17-Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 6).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: 1- pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin; 2- Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht në javën e 13-të dhe të 14-të. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët efektivë dhe me kontratë. (Evidenca-17-Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 6).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton në dokumentacionin e paraqitur në DVV, se rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht në mënyrë konfidenciale të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës të njësive kryesore. GVJ konstaton se këto rezultatet janë referuar vetëm për vitin akademik 2018-2019, (Evidenca-69-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019). Rezultatet që dalin nga pyetësorët për vlerësimin institucional grumbullohen dhe përpunohen pranë DKSC. Kjo drejtori ua përcjell rezultatet e vlerësimit eprorëve (Rektorit) dhe më pas i publikohen në formën e raporteve duke i prezantuar për të intersuarit në formën e një konference, (Ref. Takimi me përfaqësues të DKSC). Mbështetur në informacionin e dhënë në RVB, GVJ vëren se publikimi i rezultateve nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja shprehet në formën e Raportit për veprimtarinë mësimore dhe</p>

	shkencore të tij, ku përfshihen: 1-evidentimi i përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; 2 - evidentimi i përshtatshmërisë së programeve të studimit me misionin e UAMD; 3 - parashikimi bazuar në aktet e reja nënligjore, mbi angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndët dhe modulet që do zhvillohen nga secili prej tyre në çdo semester. GVJ konstaton se ky raport nuk përmban të dhëna për vlerësimin e personelit akademik që janë rezultat i plotësimit të pyetësorëve të studentëve (Evidenca-44-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022).			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar RRFOBSC, evidentohet nga GVJ se si rregull, por edhe në praktikë, fakultetet dërgojnë tabelën përkatëse, brenda muajit Shtator sipas Aneksit IV të miratuar me Vendim Rektorati, me rezultatet e vlerësimit të stafit akademik për të dy semestrat, sipas departamenteve, si dhe detyrimet që duhet të plotësojnë pedagogët me vlerësim jo të mirë, sipas shkallës së përcaktuar në Aneksin IV. GVJ u informua nga vizita në institucion se pedagogët me rezultate që reflektojnë nivele të ulëta vlerësimi nga studentët ndjekin trajnime pranë Qendrës për Edukim në Vazhdim në FE (Evidenca-17-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Neni 6; takimi në institucion).			
Konkluzione	<i>“UAMD” në linjë me Statutin e tij, i cili ka parashikuar sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe funksionimin e tij, specifikon se ky sistem mbështetet në garantimin e transparencës. UAMD ka hartuar Politikën dhe Strategjinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë të Fakultetit të Edukimit, si dhe Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë veprojnë në përputhje me dokumentat qendrorë të sipërpërmendur për garantimin e cilësisë së brendshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC),	GVJ konstaton se “UAMD” në përputhje me Kodin e Cilësisë në RSH (Evidenca-61-Kodi i Cilësisë) dhe në mbështetje të parimeve në Statutin e tij, ka ngritur struktura të posaçme për sigurimin e cilësisë së brendshme, si edhe ka hartuar politika e rregullore për të garantuar

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>standartet e cilësisë së brendshme në institucion, të tilla si: “Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit” (KPGSCIPS); “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, (NJSBC) e strukturuar në nivel institucional dhe në nivel fakulteti; Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC), (Evidenca-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE; Evidenca-17-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf Neni 8/9).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton se në përbërje të Komisionit të përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit (KPGSCIPS), është përfshirë një (1) student. GVJ nuk evidenton përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në këtë proces. “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, (NJSBC) e strukturuar në nivel fakulteti dhe institucional ushtron veprimtarinë mëshetur në dokumenta të posaçëm për garantimin e cilësisë së brendshme, por nuk ka përfshirë studentë ose ekspertë të jashtëm në përbërje të saj (Evidenca-22-Ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të FE-së; Evidenca-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>“UAMD” është pjesë e proceseve periodike të vlerësimit të jashtëm institucional, ku për herë të parë është akredituar institucionalisht në vitin 2017 për katër vite dhe së dyti në vitin 2022 (Evidenca-110-Vendimi i Bordit të Akreditimit për UAMD, 2017; Vendim Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës). Programi i studimi Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” nuk ka kryer proces akreditimi të mëparshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni përshkruar, si dhe nga vizita në institucion se UAMD nëpërmjet mekanizmave të ndërtuar nga strukturat e ngritura për monitorimin e cilësisë në institucion, si dhe mbështetur në politikat dhe strategjinë e garantimit të cilësisë ka hartuar disa lloje instrumentash matës të cilësisë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Formular i vlerësimit të studentit -Formular vetë-vlerësimi për pedagogun -Formular i vlerësimit të programit të studimit -Anketim për Alumnit -Pyetësor për vlerësimin institucional dhe shërbimet nga studenti/personeli akademik/administrata -Vëzhgime në klasë -Vlerësime për performancën shkencore nga përgjegjësi i

	departamentit (Evidenca-81-Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik, 2019; Evidenca-68-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët; Evidenca-67-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit; Dokumentacion shtesë –Pika 3 Ankete dhe raporti i Alumnit).			
Konkluzione	<i>Mbështetur në Rregulloren për sigurimin e brendshëm të cilësisë të “UAMD”, në Politikën dhe Strategjinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë të Fakultetit të Edukimit, janë ngritur struktura të posaçme për garantimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, të cilat hartojnë instrumenta monitorimi për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, personelin akademik, vlerësimin institucional, vlerësimin nga të diplomuarit në programin e studimit. Këto instrumenta dhe mekanizma vlerësues përdoren nga DGH, DKSC dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike (Sektori Alumni).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se DGJH ka hartuar raportin e vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” për vitin akademik 2021-2022, ku grupi i punës i përbërë nga katër anëtarë, të cilët janë të angazhuar në programin e studimit, kryejnë një analizë vjetore për mbarëvajtjen e procesit mësimor për këtë program studimi. GVJ rekomandon se vlerësimi i programit të studimit duhet të vijë si rezultat i vlerësimit të studentëve, me qëllim përfitimin e të dhënave më transparente mbi vlefshmërinë e tij dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm (Dok. Shtesë- pika 10- Raporti vlerësimit per programin e studimit). “UAMD” gjithashtu ka realizuar procesin periodik të vlerësimit të brendshëm për Fakultetin e Edukimit (2015/2022), ku për referencë janë konsideruar dokumenta zyrtare të institucionit dhe nuk janë përfshirë të dhëna nga instrumentat matës të hartuara nga strukturat e monitorimit të cilësisë (Evidenca-20- Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015; Dok Shtesë - pika 9- Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të Fakultetit të Edukimit). Rezultatet që dalin nga pyetësorët për vlerësimin institucional grumbullohen dhe përpunohen pranë DKSC dhe rezultatet u përcillen eprorëve (Rektorit). Në rastin e aplikimit të</p>

	<p>pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e pedagogut, pasi të dhënat përpunohen elektronikisht nga programi “Cleanscore”, rezultatet i përcillen në mënyrë konfidenciale Dekanit, i cili në vijimësi ua komunikon përgjegjësve të departamenteve. Personeli akademik mer informacionin mbi vlerësimin e tij nga studentët nëpërmjet postës elektronike. Por, <i>GVJ konstaton se rezultatet e pyetësorëve të studentëve nuk janë periodike dhe i përkasin periudhës 2018-2019, (Evidenca-69-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019).</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se në DVV janë paraqitur raporte të kufizuara mbi rezultatet e pritshme që dalin nga vlerësimet e drejtpërdrejta ku përfshihen studentët dhe personeli akademik. Konkretisht janë realizuar katër (5) raporte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- përgjigjet e anketës së studentëve ndaj personelit akademik, ku evidentohet mosperditesimi i kryerjes së sondazhit qe nga viti 2018-2019 (Evidenca-69-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019); 2- pyetësori për vlerësimin institucional i zhvilluar jo periodikisht (Evidenca-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin, 2018- 2019); 3- raporti për vetëvlerësimin e personelit akademik. <i>GVJ konstaton dhe vlerëson që DGJH kryen vlerësim periodik të personelit akademik dhe të veprimtarisë së programit të studimit, por i cili nuk është mbështetur në rezultatet e anketimeve të studentëve, (Evidenca-44-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022).</i> 4- raport i vlerësimit të brendshëm për Fakultetin e Edukimit (2022), i cili përmban analizën e përparësive dhe mangësive, si edhe rekomandime (Dok Shtesë - pika 9- Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të Fakultetit të Edukimit). 5- Rezultatet për vlerësimin nga Alumnit paraqiten në formë sasiore (tabelare) dhe shërbejnë për gjurmimin e Alumnit pas diplomimit dhe jo specifiku për vlerësimin që ata i bëjnë programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” (Dok.shtesë-pika 3- Ankete dhe raporti i Alumnit). GVJ konstaton se vlerësimi periodik i personelit akademik dhe i veprimtarisë së programit të studimit, i realizuar nga DGJH përmban analizën Swot, evidenton mangësitë dhe përparësitë e implementimit të programit të studimit. <i>GVJ rekomandon që të gjitha raportet duhet të jenë periodike si edhe të përfshijnë një plan veprimi dhe rekomandime në përfundim të analizës së rezultateve nga të dhënat e grumbulluara.</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>“UAMD” mbështetur në rregulloren për funksionimin e cilësisë në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor disa instrumenta: anketime për vlerësimin e programit të studimit, pyetësor për personelin akademik, vlerësim të didaktikës dhe kurrikulës, vlerësime paralele të provimeve dhe detyrave të studentëve, si edhe vëzhgime në auditor (Evidenca-17-Rregullorja per Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit te Brendshem te Sigurimit te Cilesise Evidenca-44-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.pdf Evidenca-67-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.pdf Evidenca-80-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022; Evidenca-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin, 2018- 2019).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton se Sektori i Karrierës dhe Alumnit në UAMD kryen anketimet e të diplomuarve Alumni me qëllim gjurmimin e studentëve pas përfundimit të studimeve (Dokumentacion shtesë-pika 3 - Ankete dhe raporti i Alumnit). GVJ konstaton se realizohen sondazhe nga studentët, personeli akademik dhe administrativ për vlerësimin institucional dhe shërbimet. DKSC është strukturë që ndjek dhe monitoron procesin e kryerjes së sondazheve, grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave. <i>GVJ rekomandon që këto rezultate të përditësohen, pasi janë kryer që nga viti, 2018-2019</i>, (Evidenca-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin, 2018- 2019).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton se institucioni përdor mekanizma dhe instrumenta matës specifike për të monitoruar dhe garantuar cilësinë e brendshme të programit të studimit, për-institucionin dhe personelin akademik, por vëren se këto matje nuk janë të përditësuar me raporte të viteve të fundit, si dhe nuk kanë qasje periodike që shërben për hartimin e plan- veprimit dhe përfshirjen e rezultateve të dala nga pyetësorët</i></p>

	<i>përkatës me qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme. GVJ konstaton se jo të gjithë raportet përmbajnë analiza të përparësive dhe mangësive, si dhe dhënien e rekomandimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë është parashikuar në statutin e UAMD-së. Konkretisht në disa struktura si: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe programeve të studimit dhe GVB, ku evidentohet se studentët janë të përfaqësuar për të garantuar përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit (Evidenca-2- Statuti UAMD, 2018; Evidenca-7-Rregullore FE 2019; Evidenca-4- Rregullore UAMD 2018; Evidenca-21-Vendim Dekanati për krijimin e GVB-ve mbi Akreditimin e Programeve në FE). GVJ konstaton se studentët nuk janë përfshirë në strukturën “NJSBC” pranë Fakultetit të Edukimit (Evidenca-22-Ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të FE-së).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstaton se detyrat për njësitë, individët dhe studentët në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit janë parashikuar në rregulloren e posaçme për garantimin e standarteve të cilësisë së brendshme dhe monitorohen nga strukturat përkatëse, KPGSCIPS, NJSBC dhe DKSC (Evidenca-17-Rregullorja për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ konstaton nga vizita në institucion dhe dokumentacioni shoqëruar se departamenti i gjuhëve të huaja është i përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”, nëpërmjet realizimit të raporteve dhe analizave vjetore, ku trajtohen aspekte si: kurrikula, mësimdhënia, kërkimi shkencor, niveli i studentëve (Evidenca-65- Analiza Vjetore e Njesise Baze per Programin 2021-2022;Evidenca-68-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët; Evidenca-69-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019).

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Konstatohet nga GVJ se për të shmangur format e ndryshme të diskriminimit, "UAMD" ka parashikuar rregulla të veçanta në rregulloret e brendshme në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Po ashtu, parimi i transparencës është përfshirë në rregulloret të posaçme (Evidenca-17-Rregullorja për Funksimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin mbështetës dhe nga vizita në institucion nuk konstaton përfshirjen e aktorëve të jashtëm në strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë ose ekspertë të ftuar në proceset e vlerësimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>"UAMD" nëpërmjet Statutit dhe Rregullores për garantimin e cilësisë së brendshme ka zbatuar parimin e transparencës, ku në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe grupeve të vlerësimit të brendshëm (GVB) ka përfshirë personel akademik të njëjësive kryesore dhe studentë, por nuk ka angazhuar ekspertë të jashtëm. Po ashtu, struktura e vlerësimit të brendshëm të Fakultetit të Edukimit, (NJSBC), nuk ka në përbërje përfaqësi nga studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion, dokumentacioni në DVV dhe shqyrtimi i materialeve fizike dhe elektronike (faqja zyrtare e institucionit) se UAMD publikon politikat, strategjinë dhe pjesërisht rezultatet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë (www.uamd.edu.al).</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Evidentohet nga vizita në institucion dhe në referencë me RRFOSBSC se rezultatet për vlerësimin institucional bëhen publike në formën e një konference për personelin akademik dhe studentët. Përsa i përket rezultateve të vlerësimit nga studentët për personelin akademik, ato përpunohen nga program elektronik “Cleanscore” dhe janë konfidenciale deri në dorëzimin tek titullari i institucionit. Rezultatet u komunikohen individualisht në formë elektronike personelit akademik për të ruajtur të drejtën e të dhënave personale, (Evidenca-17-Rregullorja për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se raporti vjetor i departamentit dhe raporti për vlerësimin e brendshëm të Fakultetit të Edukimit janë të shoqëruar me analizën SWOT, e cila adreson përparësitë dhe mangësitë lidhur me vlerësimin e brendshëm të njësive bazë, DGJH dhe FE (Evidenca-65- Analiza Vjetore e Njesise Baze per Programin 2021-2022; Dok. Shtesë- pika 9- Raporti i Vleresimit te Brendshem te Fakultetit te Edukimit).</p> <p><i>GVJ konstaton se raportet që janë rezultat i anketimeve ose sondazheve nuk shoqërohen me plan- veprimi dhe rekomandime</i> (Evidenca-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin, 2018- 2019; Evidenca-69-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019; Dokumentacion shtesë-pika 3 - Ankete dhe raporti i Alumnit).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Funksionimi i strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë si KPGSCIPS, NJSBC, DKSC garantohet nga kuadri rregullator i brendshëm, i cili monitoron efikasitetin e veprimtarisë së tyre njëkohësisht. Për këtë qëllim në hartimin e rregullores së cilësisë së brendshme dhe për ngritjen e strukturave është marë në konsideratë Kodi i Cilësisë (Evidenca-61-Kodi i Cilësisë; Evidenca-17-Rregullorja për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe dokumentacionit të paraqitur në DVV, GVJ konstaton se departamenti i gjuhëve të huaja organizon takime periodike me studentët dhe me personelin akademik me qëllim informimin e tyre për rolin që ata kanë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së brendshme. Gjithashtu DKSC kryen cikle takimesh informuese për format e monitorimit të cilësisë, kohës kur aplikohen instrumentat matës të cilësisë dhe procedurat e realizimit të vëzhgimeve në auditore.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ eidenton se rezultatet për vlerësimin institucional bëhen publike në formën e një konference për personelin akademik dhe studentët. Në faqen zyrtare të “UAMD” publikohen politikat, strategjia dhe pjesërisht rezultatet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. GVJ</i></p>

	<i>konstaton se jo të gjithë raportet e vlerësimit të brendshëm shoqërohen me një plan veprimi dhe me analizë të mangësive dhe përparësive, që dalin nga rezultatet e anketimeve, sondazheve dhe pyetësorëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” u hap rrugën studentëve për studime të mëtejshme të thelluara në programet e ciklit të dytë të studimit, “Master” në gjuhën gjermane.
2. Elementët formues të programit të studimit mundësojnë përgatitjen e specialistëve me formim gjuhësor e shkencor në gjuhën gjermane, të gatshëm për tregun e punës.
3. Stafit akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga ekspertë të kualifikuar, me tituj e grada shkencore dhe tregojnë vazhdimisht vullnet për kualifikime të mëtejshme, për rritje profesionale dhe për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies.
4. Programi i studimit realizohet në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve të shkëmbimit akademik dhe bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, në drejtim të projekteve ndërkombëtare.
5. Institucioni mbështet personelin akademik të angazhuar në programin e studimit në realizimin konferencave, seminareve, trajnimeve, leksioneve të hapura, si dhe aktiviteteve të tjera shkencore, i orientuar nga një kuadër rregullator i dedikuar për kërkimin shkencor.
6. Institucioni ka ngritur struktura dhe ka hartuar politika dhe strategji të posaçme për monitorimin e standarteve të cilësisë për programin e studimit.
7. Njësia bazë harton raporte periodike të veprimtarisë kërkimore-shkencore, si edhe kryen analizën e cilësisë për programin e studimit.

Pika të dobëta:

1. GVJ vëren se ndërtimi i planit mësimor “Gjuhë Gjermane dhe Angleze” është i orientuar në përgatitjen e të diplomuarve në këtë program studimi kryesisht në gjuhën gjermane, që bie në kundërshti me emërtimin e tij dy gjuhësh. Kuadri i veprimtarive formuese evidenton se njëri specialitet, gjuha gjermane, mer peshë më të madhe nga totali i lëndëve të ofruara për lëndët karakterizuese, konkretisht vetëm në kategorinë B, raporti është: 12 lëndë gjuhë gjermane (78 ECTS) dhe dy (2) lëndë gjuhë angleze (16 ECTS) - Standarti III.4 /Kriteri 1; Standarti II.4/ kriteri 2.
2. GVJ ka konstatuar se mekanizmat dhe instrumentat matës specifikë që institucioni ka ngritur për të monitoruar dhe garantuar cilësinë e brendshme të programit të studimit, nuk janë përdorur periodikisht, si dhe nuk janë shoqëruar me raporte të viteve të fundit që përmbajnë plan-veprimin dhe përfshirjen e rezultateve të dala nga pyetësorët përkatës me qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme - (Standarti VI.3/VI.5).
3. GVJ konstaton se literatura e përdorur në një pjesë të konsiderueshme të lëndëve, e pasqyruar edhe në syllabuse, nuk është bashkëkohore, sikurse edhe numri fizik i librave në bibliotekë për këtë program studimi është i pamjaftueshëm (Standardi IV.3 / kriteret 1 & 4).



Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që të rivlerësohet kurrikula e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Gjermane dhe Angleze" në mënyrë që ti përshtatet plotësisht emërtimit të tij dygjuhësh, duke shtuar lëndët në gjuhën angleze, sidomos në kategorinë e lëndëve karakterizuese, ku vërehet një mosbalancim i theksuar ndërmjet tyre.
2. Institucioni të kryejë dhe të raportojë nga strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dokumentacion të plotë dhe të përditësuar për vlerësimin e brendshëm, të shoqëruar me plane veprimi pas analizës së rezultateve të anketimeve.
3. GVJ sugjeron përfshirjen e studentëve edhe në strukturën NJSBC në nivel fakulteti, përpos strukturave të sigurimit të cilësisë në nivel institucioni.
4. Rekomandohet përditësimi i syllabuseve me literaturë bashkëkohore, pasurimi i bibliotekës fizike dhe rritja e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit në funksion të programit të studimit.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "German and English Language" of the Institution of Higher Education "Aleksandër Moisiu" University, Durrës

Strengths and affirmations:

1. The curriculum of the study program paves the way for students for further in-depth studies in the programs of the second study cycle "Master's Degree" in German language.
2. The formative elements of the study program enable the preparation of specialists with linguistic and scientific training in the German language, ready for the labour market.
3. The academic staff engaged in the study program is made up of qualified experts, with scientific titles and degrees and constantly shows willingness for further qualifications, for professional growth and for improving the quality of teaching.
4. The study program is carried out within the framework of the implementation of academic exchange agreements and cooperation with counterpart institutions inside and outside the country, in the direction of international projects.
5. The institution supports the academic staff engaged in the study program in conducting conferences, seminars, trainings, open lectures, as well as other scientific activities, guided by a regulatory framework dedicated to scientific research.
6. The institution has established structures and drafted special policies and strategies for monitoring quality standards for the study program.
7. The basic unit prepares periodical reports of the scientific-research activity, as well as conducts the quality analysis for the study program.

Weaknesses:

1. External Evaluation Group (EAG) notes that the formative framework of curriculum "German and English Language" is oriented to the preparation of graduates in this study program mainly in German language, which contradicts its dual language designation. The



framework of formative activities shows that one specialty, "German language", takes a greater weight out of the total number of courses offered for the characterized subjects, specifically only in category B, the ratio is: twelve (12) German language subjects (78 ECTS) and two (2) subjects' English language (16 ECTS) - Standard III.4 / Criterion 1; Standard II.4/criterion 2.

2. External Evaluation Group (EAG) has found that the specific measuring mechanisms and instruments that the institution has set up to monitor and guarantee the internal quality of the study program, have not been used periodically, and have not been accompanied by reports from recent years that contain the action plan and the inclusion of the results obtained from the relevant questionnaires in order to improve the internal quality - (Standard VI.3/VI.5).
3. External Evaluation Group (EAG) proves that that the literature used in a significant part of the courses, reflected in the course syllabus, is not contemporary, as well as the physical number of books in the library for this study program is insufficient (Standardi IV.3/ kriteret 1 & 4).

RECOMMENDATIONS

1. External Evaluation Group (EAG) recommends that the curriculum of the Bachelor study program in "German and English" be re-evaluated so that it fully fits its bilingual designation, adding subjects dedicated to English language, especially in the category of characterizing courses, where it is noted a highlighted imbalance between the two languages.
2. The institution should carry out and report complete and updated documentation for the internal evaluation, accompanied by action plans after the analysis of the results of the surveys by the units responsible for quality assurance.
3. External Evaluation Group (EAG) suggests the inclusion of students in the Unit for Internal Quality Assurance (NJSBC) structure at the faculty level, in addition to those at the institution level.
4. It is recommended to update the syllabuses with contemporary literature, enrich the physical library and increase the capacities of information technology devices in function of the study program.

Two handwritten signatures in blue ink are located at the bottom right of the page. The signature on the left is a stylized 'AB' and the signature on the right is a more complex, cursive signature.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

